

A është doktrina e Trinitetit

frymëzim hyjnor?

Autori: M. A. C. Cave

Përktheu: Vullnet Mehmeti

A është doktrina e

Trinitetit frymëzim

hyjnor?

Autori: M.A.C. Cave

Përktheu: Vullnet Mehmeti

www.islamic-invitation.com

Kushtim

Këtë punë modeste të hulumtimit shkencor ia kushtoj Zotit xh.sh. për atë që më dhuroi mua urtësi, gruas sime Nenet, ndihmëse e dashur për mua me një zemër bujare, nënë që kujdeset për fëmijët tanë. Ajo është një grua e dëlirë, e virtytshme dhe që e ka frikë Zotin.

Dhe të gjithë fëmijëve të mi për entuziazmin dhe mbështetjen e tyre, miqëve të mi, dhe të afërmve për besnikërinë e tyre, dhe në përkujtim të prindërve të mi që përjetuan vuajtje dhe mundime të shumta nga pafuqia dhe dobësia ime e vazhdueshme, e megjithatë dashuria dhe ndjenjat e tolerancës së tyre po më përshkojnë trupin.

Së fundi unë ua kushtoj të gjithë miqëve të mi nga gjiri i popullit dhe u jam mirënjohës për fjalët e tyre që shprehin inkurajim dhe mbështetje të pakompromis për botimin e këtij libri.

*M.A.C Cave
15 Gusht 1996*

MIRËNJOHJE

Në përulje të plotë, unë i pranoj bekimet e Zotit dhe e falënderoj Atë që më mundësoi të dalë në dritë ky libër duke e bërë realitet këtë dëshirë time të flaktë.

E pranoj se ia kam për borxh Dr. Maneh Al-Johani-t, Sekretar i përgjithshëm i Asamblesë Botërore të Rinisë Islame (WAMY) për publikimin e këtij punimi të hulumtimit shkencor.

Falënderimet e mia të singerta të gjithë dashamirësve të cilët më dhanë përkrahje dhe ndihmë në këtë punim me

detaje teknike me zemërgjerësi dhe paanësi të plotë. Shpreh mirënjohjen time të singertë për të gjithë ata të cilët punuan me zell dhe singjeritet për të nxjerrë në dritë këtë botim.

Lus Zotin e Plotëfuqishëm, nga mëshira e Tij e pakufishme të lëshojë bekimet e Tij mbi të gjithë ata. Amin!

M.A.C. Cave

Në Ungjillin e Gjonit në Bibël (Gjoni 8:40) Jezusi – Isai a.s. (shkurtesë për: `alejhis-selam` - `Paqja qoftë mbi të) thotë:

"Por ju tani kërkoni të më vrisni mua, që ju kam folur të vërtetën që kam dëgjuar nga Perëndia."

Kurse Allahu (Zoti) në Kur'an (Ali Imran, 3:59) thotë:

"Vërtetë, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: 'Bëhu!' ai u bë."

Realiteti i Njëshmërisë së Zotit dhe karakteri i rolit të Jezusit a.s., sipas shkrimeve biblike:

Hedhja poshtë e konceptit të Mishërimit të Zotit dhe të Trinitetit nuk e diskrediton Jezusin, por në fakt e ngre Zotin në pozitën e Tij të ngritur, unike, të lartësuar dhe të pashembullt si Hyjnia e vetme e vërtetë që meriton të adhurohet. Jezu Krishti nuk është Zot por Profet i madh dhe i Dërguar i Zotit!

Përbajtja

<i>Hyrje.....</i>
<i>Parathënie</i>
<i>Raporte të mediave speciale nga Britania e Madhe.....</i>
<i>Të krishterët.....</i>
<i>Doktrina e Trinitetit.....</i>
<i>Si u zhvillua Triniteti dhe u shëndrrua në një doktrinë krishtere.....</i>
<i>Faktorët që ndikuan në doktrinën e Trinitetit.....</i>
<i>Justifikimi i doktrinës së Trinitetit nga ana e trinitarëve.....</i>
<i>Doktrina e Trinitetit nuk është mësuar nga të krishterët e hershëm.....</i>
<i>A flet Bibla për doktrinën e Trinitetit?.....</i>
<i>-Rreth shkrimeve hebraike.....</i>
<i>-Rreth shkrimeve greke.....</i>
<i>Hedhja poshtë e dotrinës së Trinitetit nga të krishterët modern.....</i>
<i>Mësimet e Profetëve të Zotit.....</i>
<i>Çka thotë Bibla për Zotin dhe Jezusin a.s.....</i>
<i> 1.Dëshmia e Biblës për Zotin.....</i>
<i> 2.Dëshmia e Biblës për Jezusin a.s.....</i>
<i> 3.Çka thotë Jezusi a.s. për Zotin dhe veten.....</i>
<i>Çka thotë Kur'ani për Zotin.....</i>
<i>Faktet biblike për doktrinën e Trinitetit.....</i>
<i>Argumente shtesë për hedhjen poshtë të dotrinës së Trinitetit.....</i>
<i>A e miratoi Jezusi a.s. konceptin e Shpirtit të Shenjtë.....</i>
<i>Çka është Kur'ani dhe çka thotë për Jezusin a.s. dhe nënën e tij.....</i>
<i>Tregim i çuditshëm.....</i>
<i>Paralajmërim për ata të cilët e parandalojnë Mesazhin e Zotit.....</i>
<i>Shënime dhe bibliografia.....</i>

Hyrje

Ky botim i librit "**A është doktrina e trinitetit frymëzim hyjnor?**" do të shërbejë si ushqim për të menduarit e çdonjërit që ka mendje të shëndoshë dhe ndjekësve të krishterizmit modern. Koncepti i Trinitetit i ka hutuar të gjithë ata krishterë që thirrin në të. Edhepse z. M.A.C. Cave ishte i krishterë i cili besonte më parë në Trinitet, kur ai e kreu hulumtimin e tij përreth origjinës së kësaj doktrine, ai zbuloi duke qenë krejtësisht i habitur se ka qenë një përpunim vonë i sajuar që është përfytyruar dhe është projektuar nga ana e shkrimtarëve dhe mendimtarëve të ndryshëm.

Z. M.A.C. Cave grumbullon prova dhe fakte se Triniteti nuk është asgjë tjetër veçse një doktrinë të cilën e ka nxjerrur njeriu nga vetja e cila nuk barazohet që të jetë shpallje nga Zoti. Më pas, kjo doktrinë e thurrur nga njeriu e humbën ngathtësinë e saj për arsy se ngërthen në vete kontradikta dhe rezulton si problematikë e vështirë te hierarkitë krishtere në përgjithësi, e në veçanti te klerikët që përpiken për ta mbështetur atë.

Është e papranueshme nga ana e personit që mendon drejtë të kapet për kësaj dogme duke patur paraysh gjithë të metat e saj. Njeriu duke qenë racional, ai do të ishte më kritik në çështjet që kanë të bëjnë me aspektin shpirtëror që janë thelbësore për jetën e tij. Ai do të përpiquej t'i përgjojë shkrimet fetare të të tjerëve duke ecur rreth e rrotull për ta gjetur të vërtetën bindëse. Dhe, nuk do t'i lejonte vetes që të jetë viktimë e vetëkënaqësisë dhe besimit të verbër siç I ka ndodhur në të kaluarën. Mundohuni që të pasqyroni shiqimin në vargjet e shkrimeve të shenjta:

Apeloj deri te lexuesit që ta shqyrtojnë këtë libër dhe të gjykojnë me paanshmëri dhe me zemër të hapur ndaj së

vërtetës, sepse kjo është e vëtmja rrugë e cila na shpie në vendimin e duhur, e që rregullon jetën e njeriut në këtë botë dhe në tjetrën.

Parathënie

S'ka gjë që i ofendon më tepër të krishterët se sa të fusësh dyshime në doktrinën e Trinitetit, burimin kryesor të besimit të tyre. Që në fëmijërinë time si i krishterë, kam ditur bindshëm se një pasues i devotshëm i krishterizmit me siguri që do të lëndohet, nëse e kundërshton për diçka që ai e njihte si të vërtetë. Por, për ta ndjekur verbërisht duke ditur se ka diçka më të mirë është largim nga rruga e drejtë pasi që unë jam detyruar përpara urdhërave të Zotit që t'i largoj ata të devijuar nga doktrina e pavërtetë. Është një e drejtë parësore e çdo individi që ta dijë të vërtetën e cila do ta shpie atë në rrugën e drejtë.

Është fakt se njeriu është krijuar si një qenie rationale, kështu që ai posedon kapacitetin e arsyes. Lidhur me të, njeriu gjithmonë ka prirjen për të kërkuar të vërtetën. Andaj, si individ, pritet nga ai që t'i arsyetojë gjërat në mënyrë objektive, me anë të fjalëve dhe veprave të tij për të arritur qëllimin e tij. Më tej, ai është i nderuar me lirinë e zgjedhjes që i mundëson atij të përshtatet në një shoqëri të civilizuar. Është po aq e vërtetë se askush nuk ka të drejtë ta detyrojë dikë që ta pranojë dhunshëm qoftë edhe të vërtetën. Megjithatë, është një lloj arrogance dhe kokëfortësie për një qenie rationale që ta hedhë poshtë të vërtetën. Njerëzit të cilët ndjekin parimet jo vetëm që e përkrahin "të vërtetën", edhe nëse ajo është e hidhur, por gjithashtu janë të gatshëm për ta mbrojtur atë të vërtetë në çfarëdo rrethane deri në atë shkallë saqë edhe flijojnë jetën e tyre.

Triniteti është i rrënjosur thellë në mesin e të krishterëve që rrallë ndodh që ndonjëri ta vrasë mendjen se çka nënkuptohet nga "tre në një Zot". Edhepse origjinën e

ka nga besimet pagane, shumica e tyre nuk pyeten kurrë mes veti për vërtetësinë e një doktrine të tillë, duke mos patur njoħuri se është e shpikur nga njeriu dhe nuk është nga frysmezimi hyjnor. Doktrina e Trinitetit thotë:

"Ati është Zot, Biri është Zot, Shpirti i Shenjtë është Zot, e sëbashku këta formojnë vetëm një Zot. Triniteti është pérjetësi e pérbashkët, pa fillim apo mbarim, dhe barazi e ndërsjelltë." (1)

Jezusi a.s. është konsideruar nga trinitarët se ka dy natyra – njerëzore dhe hyjnore. E besojnë se është Biri i Zotit dhe është Zoti i plotë pasiqë është personi i dytë në Hyjninë e doktrinës së Trinitetit.

Megjithatë, në këtë libër, lexuesit do të zbulojnë se disa të vërteta të shpallura kanë qenë qëllimi sh tē zvetënuara nga ana e mendimtarëve, shkruesëve, teologëve, shkrimtarëve, evangjelistëve krishterë dhe kishave në mënyrë që t'i vërtetojnë pretendimet e tyre se doktrina e Trinitetit buron nga "frysmezimi hyjnor". Përpara gjatë kohe, profeti Jeremia a.s. paralajmëroi njerëzit pér bastardimin që është bërë në shpalljet hyjnore nga ana e atyre që predikojnë fenë e Zotit. Ai thotë:

"Si mund tē thoni: "Ne jemi tē urtë dhe ligji i Zotit është me ne"? Por ja, pena e rreme e shkruesve e ka bërë një falsitet." (Jeremia 8:8, Bibla)

Përsa i përket konceptit të gabueshëm tē adhurimit, profeti Jesus (Isa a.s.) na e ka përsëritur paralajmërimin me tē cilin na njoftoi profeti Isaia a.s., por njerëzit janë me tē vërtetë tē pavëmendshëm. Ai thotë:

"Ky popull po më afrohet me gojë dhe më nderon me buzët; por zemra e tyre rri larg meje. Dhe më kot më nderojnë, duke i mësuar doktrina që janë urdhërime nga

njerëzit." (Mateu 15:8-9, Bibla)

Vendimi im për të nisur rrugën e kësaj aventure në kërkim për të vërtetën në lidhje me konceptin e Trinitetit. Hulumtimi nuk ishte vetëm duke iu përmbajtur shkrimeve biblike, por gjithashtu edhe traktateve dhe artikujve të dijetarëve religjioz. Disa nga punimet e tyre dëshmuan bujshëm dhe morrën pëlqim nga ana e sekteve krishtere.

Hulumtimi është bërë me një mendje të hapur e pa paragjykime, duke patur parasysh besimin tim të mëparshëm në doktrinën e Trinitetit. Në fakt, ideja filloj në kërkim për dëshmi të qartë e të kapshme për të vërtetuar autenticitetin e këtij besimi, e jo mënyrën e kërkimit që vërteton origjinën e vetë besimit se nuk është nga Zoti. Më tej, në mënyrë që të jesha objektiv, kam përdorur materiale referimi që më kanë rënë në dorë.

Në të vërtetë, ishte një përpjekje duke kërkuar me gjithë shpirt ashtu që të mund t'i vlerësoj faktet ashtu siç vijnë me rradhë njëra pas tjetrës gjatë dëshmisë. Për fat të keq, ashtu siç vazhdonte hulumtimi, mendohej se doktrina e Trinitetit kaloi tek brezat e rinj si një e vërtetë përfundimtare, por në fakt ajo ishte duke kaluar në agoni. Sikur që të ishte rezultati në favor të saj, ajo do të ma kishte ndriçuar zemrën. Megjithatë, në drojën dhe ankthin që jam, e konstatova atë se është e gabuar. Kjo doktrinë e bërë nga njeriu është shpikur nga ata njerëz për t'u shërbyer interesave të tyre vetjake dhe të drejtave të ligjshme të fituara. Kështu që, të gjitha pretendimet e mëparshme dolën se janë absolutisht të pavërteta. Doktrina e Trinitetit nuk është vetëmse kundër mësimeve të profetëve të Zotit, por gjithashtu është një ofendim ndaj intelektit të njeriut ngaqë ajo është në kundërshtim me arsyen dhe nuk figuron askund në Bibël.

Së fundi, e vërteta e hidhur është që ajo e shkatërron doktrinën e Trinitetit dhe atë të Mishërimit së bashku me të

gjitha besimet e përafërta. Për të adhuruar Zotin në përputhje me Udhëzimin e Tij të shpallur paraqet hedhje poshtë në tërësi të atyre besimeve.

Duke hedhur poshtë konceptin e Mishërimit të Zotit dhe atë të Trinitetit nuk shpie në humbje të besimit në Jezusin, por përkundrazi e vë Zotin në pozitën e Tij të ngritur, unike, të lavdëruar dhe të pashembullt si hyjni e vetme e vërtetë që meriton të adhurohet. Jezu Krishti nuk është Zot por një profet i madh dhe i Dërguar i Zotit!

Unë i ftoj të gjithë që ta kërkojnë të vërtetën në librin tim, me anë të së cilit do të hapen zemrat e atyre që kanë dëshirë të madhe për shpëtim.

"Zoti ynë! Përmes kësaj pjese të punës ne jemi përpjekur që të përcjellim kuptimin e saktë të mesazhit Tënd për njerëzimin. O Zoti ynë, lëshoi bekimet e Tua dhe udhëzoi ata në të vërtetën. Kudo që kemi vepruar gabime, të lutemi që të na falësh dhe t'i mbrojsh njerëzit nga të metat tona." Amin

Raporte të mediave speciale nga Britania e Madhe

Anketa tronditëse e peshkopëve anglikanë

Valët tronditëse mbulojnë tërë Anglinë dhe botën krishtere, kur u shfaq një raport në '**Daily News**' të Mbretërisë së Bashkuar të Anglisë me titull: "Anketa tronditëse e peshkopëve anglikanë", në të cilin është raportuar se më shumë se gjysma e peshkopëve anglikanë të Anglisë pajtohen se: "Të krishterët nuk janë të detyruar të besojnë se Jezu Krishti është Zot". Nga votimet që janë bërë nga 39 peshkopë të Anglisë, 31 prej tyre e kanë

mohuar **hyjnинë** dhe **ringjalljen e Jezusit**, pra këto dy doktrinat më themelore të krishterizmit biejnë poshtë duke u shpallur si krejtësisht të pavlefshme.

Ata i atribuojnë këto koncepte të vjetra se janë pasojë e pasaktësive që ndodhen në Bibël. (2)

JO ZOTI – POR "PËRFAQËSUESI I LARTË I ZOTIT"

Raporti më tej thekson se nga 31 peshkopë, 19 prej tyre pajtohen se: "*Mjafton që ta konsiderojmë Jezusin si Përfaqësues të lartë të Zotit*". (3)

Kështu pra më shumë se gjysma e peshkopëve anglikanë të Anglisë e shfajësuan veten nga blasfemia (sharja e Zotit) dhe e konsideruan Jezusin vetëmse si të dërguar të Zotit.

Peshkopi David Jenkins i kritikon doktrinat themelore krishtere

Në një intervistë në televizionin "London's Weekend" në emisionin fetarë "Credo", peshkopi i sapoemëruar i Durbanit – prof. David Jenkins, i cili është në rangun e katërt nga gradët e larta të Peshkopëve në Kishën e Anglisë – pati për synim që të sulmojë bazën e luhatshme të besimit mbi të cilën qëndron e tërë struktura e krishterizmit. Peshkopi kritikoi dokrinat themelore krishtere, ndër ta 'Hyjnia e Jezusit' dhe 'Ringjallja e tij', duke shprehur se ngjarjet të cilat përcillen nga fillimi i misionit profetik të Jezusit: "*Nuk janë kursesi të vërteta, por vetëmse janë të shtuara në historinë e Jezusit nga të krishterët e hershëm, me anë të cilës shprehën besimin e tyre që ai konsiderohet si Mesia*". (4)

Ky koncept për Zotin dhe Jezusin a.s. është i përhapur nga të gjithë apostujtë, të krishterët e hershëm, dijetarët

krishter të moçëm dhe ata bashkëkohor, mendimtarët, shkrimtarët, madje edhe nga krishterët e rëndomtë. Në (Mateu 4:10, Bibla) Jezusi a.s. thotë:

"...sepse është shkruar: "Adhuro Zotin, Perëndinë tënë, dhe shërbeji vetëm atij."

Në (Gjoni17:3, Bibla) thotë: *"Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar."*

Vallë a nuk janë këto deklarime të qarta? Prej ku vjen që Jezusi a.s. të pranohet si Zot? Nga kjo vjen pyetja që ka vlerë miljardë dollarë: **"A është doktrina e trinitetit frysëzim hyjnor?"**

Të krishterët

Afër një miljardë njerëz në mbarë botën akoma vazhdojnë të besojnë dhe ta vënë në zbatim doktrinën e trinitetit, ndërkohë që dyfishi i tyre - nëse jo shumica e tyre – hapurazi e hedhin poshtë për toke trinitetin, duke thënë se kjo nuk është biblike, por thjeshtë një doktrinë e gabuar, e pabazë, e pakuptimtë dhe në kundërshtim me arsyen e shëndoshë.

Sipas Bamber Gascoigne, në librin e tij *"Të krishterët"* konstatohet se për pesëdhjetë vitet e para të asaj që ne tani e quajmë 'epoka krishtere', nuk ka mbijetuar asnjë fjalë nga asnjë dokument që shkruan në lidhje me Jezusin a.s. apo pasuesit e tij. Gjatë pesëdhjetë viteve që vijuan, vetë të krishterët shkruajtën shumicën e librave që tani përbën Dhjatën (Besëlidhjen) e Re. Por akoma as edhe një fjalë, me një përjashtim të vogël, nuk është shkruar nga ndonjë autor i huaj. E më pas, në shekullin e dytë, autorët romak

filluan që të komentojnë: (5)

"Ekziston një grup, që është i urejtur për neveritë e tyre, e që janë të quajtur nga populli 'të krishterë'. Krishti, nga i cili vjen emri, pësoi dënimin ekstrem gjatë mbretërimit të Tiberit në duart e njërit prej zyrtarëve të tij, Pontious Pilate." (Tacitus)

"Të krishterët janë një klasë njerëzish që janë dhënë mbas një paragjykimi të shpikur dhe të ligë." (Suetonius)

"Të ngratët qyqarë e kanë bindur veten se do të janë të pavdekshëm dhe do të jetojnë përgjithmonë, duke e adhuruar sofistin e kryqëzuar dhe duke jetuar në bazë të ligjeve të tij. Prandaj, ata i përbuzin gjërat e kësaj bote duke i konsideruar ato pasuri të përbashkëta. Ata i marrin këto doktrina nga vetë tradita, pa ndonjë dëshmi të saktë. Pra, nëse ndonjë sharlatan apo mashtrues vjen në mesin e tyre, shumë shpejt do të përfitojë pasuri duke e shfrytëzuar këtë popull të thjeshtë." (Lucian)

Megjithatë, krishterizmi lulëzoi dhe u bë një fe e madhe, por mësimet e krishterizmit bashkëkohor siç e njohim ne sot, janë ndryshe nga ato mësime që ua mësoi Jezusi a.s. dishepujve të tij. Doktrinat e ndryshme të krishterizmit siç është triniteti, ishin një zhvillim i mëvonshëm. Zanafilla e tij filloj që nga koha e sundimit të Perandorit Konstandini i Madh (në Nikea) e më vonë e shëndrruar në një dogmë të madhe në kohën e perandorit Teodos në vitin 381. Gjë shumë e çuditshme! Që atëherë, krishterizmi ka filluar të ndahet në sekte të ndryshme, kështuqë tani është vështirë që të njohësh besimin e vërtetë krishter. Por sidoqë të jetë, në kontekstin e tanishëm, asnjëri nuk është i afërt me mësimet origjinale të profetëve, ngaqë ata i bazuan mësimet e tyre në Bibël, e cila është subjekt i nënshtuar për rishikim të vazhdueshëm.

Vetëm Zoti e di se kur do të janë në gjendje të krishterët që ta tregojnë kopjen e saktë (të vërtetë) të Shkrimeve të shenja të tyre (Biblës).

Mund të çuditet ndokush në numrin e madh të versioneve të botuara të Biblës që janë në qarkullim sot. Secili version është më ndryshe se tjetri, e megjithatë secili sekt pretendon që versioni i tij të jetë ai origjinali. Secili prej tyre kanë fituar njëfarë prirjeje që të deklarojnë përpara botës se vetëm versioni që posedojnë është i vetmi frymëzim hyjnor. Referimi i tyre i gatshëm është në (2 e Timoteut 3:16, Bibla) ku thuhet: "*I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia...*". Por ajo që nuk e kuptojnë të krishterët është se kryesisht përbajtjet e Biblës së tyre nuk janë shkrime të shenja, por vetëmse tregime, shpjegime të dhënash, ngjarje dhe tradita. Problemi bëhet më i ndërlikuar kur arrijmë të njohim se disa versione të Biblës përbajnë më tepër kopje librash se të tjerët. Versioni Ortodoks (OVC) përmban 86 libra; Versioni Karizmatik (CV) përmban 76 libra; Versioni Katoliko-Romak (RCV) përmban 73 libra dhe të gjithë versionet protestante përbajnë 66 libra duke përfshirë edhe 'The New World Translation of the Holy Scripture [1984]' (NW), të cilën e përdorin dëshmitarët e Jehovait, si dhe versione tjera siç janë versionet 'The King James [1611 – 1942]' (KJ), 'American Standard [1901 – 1944]' (AS), 'Revised Standard [1971]' botimi i dytë (RS), 'Jerusalem Bible [1966]' (JB), 'Good News Bible – Today's English Version [1976]' (TEV), 'The Holy Bible' (1954: e shtypur më 1956), 'Ronald A. Knox' (Kx), 'New International Version' (NIV) dhe versione tjera të panumërtë.

Për më tepër se çka thuhet në lidhje me deklaratat e redaktorëve të shquar të Biblës për versionin 'The Revised Standard' (RS), botim i korriguar i vitit 1952, si dhe për Dhjatën e Re, botimi i dytë i vitit 1971, nga shtëpia botuese Wm. Collins Sons & Co Ltd, publikuar për 'Canadian Bible Society', ku në parathënien e saj thuhet: (1) "*Tashmë versioni 'The King James' ka defekte të rënda... këto defekte janë aq të shumta dhe aq serioze saqë kërkohet të rishikohet përkthimi anglisht.*" (2) "*Versioni 'The King James'*

në *Dhajtën e Re ishte bazuar në një tekst grek që është i gjyqtë për shkak të gabimeve*". E çka të themi në lidhje me akuzat e dëshmitarëve të Jehovait në publikimin e tyre 'Awake' në shtator të vitit 1951 ku thuhet: "*Bibla ka 50.000 gabime!*"

E, çka nëse them diçka që është në kundërshtim me besimet tonë se "*asnjeri nga katër shkruesit e Ungjillit nuk ishin dishepuj (nxënës) origjinal të Jezusit a.s.*" Në (Luka 6:14-16) dhe (Marku 3:17), i gjejmë emrat e dy mbëdhjetë dishepujve të emëruar nga ana e Jezusit a.s. Ndërkohë që emrat e Mateut dhe Gjonit janë të përfshirë aty, ndërsa emrat e Markut, Lukës dhe Palit nuk janë të përmendur dot.

Megjithatë, nga citimet e mëposhtme, do të gjeni se dy ungjijtë që i atribuohen Mateut dhe Gjonit, përkatësisht janë të shkruar nga një person i tretë. Lexo citimet të vargjeve në (Mateu 9:9, Bibla):

"Pastaj Jezusi, duke shkuar tutje, pa një burrë që rrinte në doganë, i quajtur Mate, dhe i tha: ``Ndiqmë!``. Dhe ai u çua dhe e ndoqi."

Dhe në (Gjoni 21:24, Bibla):

"Ky është dishepulli që dëshmon për këto gjëra dhe që ka shkruar këto gjëra; dhe ne dimë se dëshmia e tij është e vërtetë."

Në rastin e parë, shkruesi (biblik) ka transmetuar vetëm atë që ka ndodhur mes Jezusit a.s. dhe njerun i quajtur Mate, ndërsa në rastin e dytë është qartë se përemri 'Ne' i kthehet shkruesit biblik.

Tani, le të shohim atë që thanë dy dijetarët krishterë në lidhje me përpilimin e Biblës:

"Ndonjëherë ka ndodhur që një kopist të mos vëndojojë

diçka që është në tekst, por vëndon atë që ai mësoi të ketë qenë në të. Ai mund të mbështetet në një kujtesë të paqëndrueshme, apo mund ta bëjë tekstin në përputhshmëri me pikëpamjet e shkollës të cilës i përket. Përveç versioneve dhe citimeve nga etërit krishterë, gati katërmijë dorëshkrime greke MSS të dhjatës, ishin të njojur që ekzistojnë. Si rezultat i kësaj, pati lexime në variacione të konsiderueshme." (6)

"Pra, përpilimi i ungjijëve në mënyrë të qartë pasqyron konceptin e nevojave praktike të komunitetit për të cilin ishte duke u shkruar në të. Janë përdorur të dhëna nga tradita, por nuk pati asnëfarë hezitimi në ndryshimin e saj, apo për të shtuar dicha që është as më i madh e as më i vogël se tjetri; thuhet që të jetë secili prej tyre një Zot i kompletuar në kuptimin e fjalës, e që i përfshin atributet e Zotit dhe se të gjithë janë të barabartë në kohë, pozitë, fuqi (pushtet) dhe njojuri (dije). Kjo doktrinë formon thelbin dhe shtyllën e besimit krishterë të cilën e pranojnë pothuajse të gjitha sektet që thirren në emër të krishterizmit. Megjithatë, doktrina e trinitetit nuk është fryshtëzim hyjnor, por një dogmë që ka dalë nga vetë njeriu e që është shpikur nga të krishterët gjatë çerekut të fundit të shekullit të katërt. Në fakt, ai ishte rezultati i Këshillit të Konstantinopojës në vitin 381, në të cilin anëtarët ranë dakord për të vendosur Shpirtin e Shenjtë në të njëjtën pozitë me Zotin dhe Jezu Krishtin.

Doktrina e Trinitetit

Doktrina e trinitetit konsiderohet të jetë një Zot në tre persona. Secili prej tyre thuhet të jetë pa fillim që ka ekzistim të përjetshëm. Secili konsiderohet i Plotfuqishëm dhe secili me madhërinë që ka është as më i madh e as më i vogël se tjetri; thuhet që të jetë secili prej tyre një Zot i kompletuar në kuptimin e fjalës, e që i përfshin atributet e Zotit dhe se të gjithë janë të barabartë në kohë, pozitë, fuqi (pushtet) dhe njojuri (dije). Kjo doktrinë formon thelbin dhe shtyllën e besimit krishterë të cilën e pranojnë pothuajse të gjitha sektet që thirren në emër të krishterizmit. Megjithatë, doktrina e trinitetit nuk është fryshtëzim hyjnor, por një dogmë që ka dalë nga vetë njeriu e që është shpikur nga të krishterët gjatë çerekut të fundit të shekullit të katërt. Në fakt, ai ishte rezultati i Këshillit të Konstantinopojës në vitin 381, në të cilin anëtarët ranë dakord për të vendosur Shpirtin e Shenjtë në të njëjtën pozitë me Zotin dhe Jezu Krishtin.

Në Enciklopedinë britaneze përmendet se: Koncepti i unitetit të esencës (homoousia) të fjalës hyjnore (The Divine Logos) e mishëruar në Krishtin me Zotin Atë formon hyjninë e plotë të Jezu Krishtit. Misteri i personit të Jezu Krishtit mund të kuptohet nga formula: dy natyrat në një person...nuk është përfituar kryesisht nga mësimi abstrakt, por ajo ndryshon në kuadër të liturgjisë në forma të reja të ndryshme dhe në himne të panumërtë të adhurimit – siç është në fjalët e liturgjisë së Pashkëve:

"Mbreti i qiejve u shfaq në tokë pa patur sjelljen e njeriut dhe ai u shoqërua me njerëz. Andaj ai morri mishin e tij nga një virgjëreshë e pastër dhe doli përpara saj duke dhënë shenjë pranimi. Një është Biri, i dyfishtë në esencë, por jo në person. Andaj në shpalljen e tij si Zot i vërtetë i përsosur dhe njeri i përsosur, ne e pranojmë Krishtin si Zotin tonë." (8)

Në kredon e Atanasëve thuhet:

"Një është personi i Atit, tjetër është i Birit dhe tjetër është i Shpirtit të Shenjtë. Por hyjnia e të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, është e tërë një; Lavdia është e barabartë, Madhështia është e përbashkët në përjetësi... I Ati është Zot, i Biri është Zot dhe Shpirti i Shenjtë është Zot. Dhe megjithatë përsëri nuk janë tre Zota, por një Zot... Ashtu siç jemi të detyruar nga vërtetësitetë krishtere që të pranojmë se çdo person nga këta të tre të jetë Zot dhe Perëndi në vete, atëherë pra e kemi të ndaluar nga feja katolike që të themi se ka tre Zota, apo tre Perëndi." (9)

Përkufizimi ortodoks në lidhje me trinitetin krishter dhe kredon e Atanasëve thotë: *"Doktrina e trinitetit përcakton që i Ati është Zot, i Biri është Zot, Shpirti i Shenjtë është Zot dhe sëbashku, e jo veçmas, ata janë nga një Zot. Triniteti është përjetësi e përbashkët, pa fillim dhe pa mbarim, në një shkallë të barabartë."* (10)

Kisha Katolike Romake thotë: "Triniteti është termi që përdoret për të treguar doktrinën themelore të fesë krishtere..." Ndërkohë Kisha Ortodokse Greke, trinitetin e quan si "doktrina themelore e krishterizmit", madje thonë: "Të krishterë janë ata të cilët e pranojnë Krishtit si Zot." Në librin "Our Orthodox Christian Faith", e njëjtë kishë deklaron: "Zoti është trinjësor... I Ati është plotësisht Zot. I Biri është plotësisht Zot. Shpirti i Shenjtë është plotësisht Zot." (11)

Si u zhvillua Triniteti dhe u shëndrrua në një doktrinë krishtere

Persekutimi i të krishterëve dhe shtypjet që i ushtronte ndaj tyre Kisha e hershme nën urdhërin e perandorisë romake e cila filloi në shekullin e parë, kurse përfundoi me ardhjen e Konstandinit të Madh në pushtet në Urën Milvio në vitin 312. Si pasojë e kësaj, nëpërmes të konvertimit në krishterizëm, njerëzve u ofroheshin favorizime speciale në formë të përfitimeve politike, ushtarake dhe shoqërore. Si rezultat i kësaj, me mijëra jo të krishterë iu bashkangjitën Kishës dhe iu mundësua Konstandinit që të zotërojë me anë të pushtetit të madh mbi çështjet e Kishës.

Gjatë sundimit të Konstandinit doli ideja se Jezu Krishti është Zot i barabartë me Atin Zot, e cila morri vrull në përhapje. Megjithatë, Triniteti nuk ishte akoma në atë kohë një doktrinë e themeluar. Ideja për një Zot të trinjësuar ka ngjallur polemika të mëdha brenda Kishës, nga shkaku se një numër i madh i klerikëve dhe laikëve nuk e pranuan që ta vëndojnë Krishtit në pozitën si Zot. (12)

Kjo mosmarrëveshje ka arritur nivelin e konfrontimit midis Peshkopisë së Aleksandrit të Aleksandrisë-Egjipt dhe meshtarit të tij Arius. Peshkopi Aleksandër i mësoi të tjerët nëpërmes ligjërimeve se Jezusi ishte i barabartë me Zotin, por nuk e bëri Ariusi një gjë të tillë. Kështu që, në një sinod

(këshill) të mbajtur në Aleksandri në vitin 321, Ariusi u shkarkua nga detyra dhe u shkishërua (përjashtua). (13)

Ariusi, duke qenë i ambientuar në rrethana të mospëlqimit institucional, akoma kishte shumë mbështetje jashtë Egjiptit. Shumë prej peshkopëve me pozitë të lartë, siç ishte historiani i mirënjohur Eusebius, peshkopi i Caesarea të Palestinës dhe emnaku i tij i fuqishëm, Eusebius, Peshkopi i Nikomedisë, teologjikisht ranë dakord me Ariusin: **Jezu Krishti nuk është Zot.** (14)

Polemika e vazhdueshme e shqetësonte Konstandinin dhe në mënyrë që ta ligjëroj qëndrimin e tij, në Maj të vitit 325 ai i ftoi të gjithë peshkopët e Kishës krishtere në Nike (vend i cili tani ndodhet në Azinë e Vogël). Këshilli i Nikesë filloj që të shqyrtojë në zgjidhjen e konfliktit që ka të bëjë me lidhjen midis Zotit Atë dhe Të Birit. Konstandini, i cili ishte në krye të mbledhjes, ushtroi forcën e tij politike që t'i shtyej peshkopët në pranimin e qëndrimit të tij teologjik. Kredoja që u nënshkrua nga 218 peshkopë ishte qartazi kundër Arianëve. Me fjalë tjera, Kredoja e Nikesë miratoi pozitën e Të Birit si i barabartë me Zotin Atë. Dyqind e tetëmbëdhjetë peshkopë e nënshkruan këtë kredo, edhepse në të vërtetë ajo ishte puna e një pakice. (15)

Enciklopedia britaneze përbledh procedurat e Këshillit të Nikesë për atë që u diskutua siç vijon:

Këshilli i Nikesë i mbajtur më 20 Maj, të vitit 325. Konstandini u vetëemrua kryetar i këshillit, duke e udhëhequr në mënyrë aktive diskutimin dhe personalisht e propozoi (pa dyshim në nxitjen e Ossius) formulën vendimtare duke shprehur lidhjen e Krishtit me Zotin në kredon që u lëshua vendimi nga ana e këshillit, "**është i të njëjtës substance me Atin.**" Nga frikësimi dhe shtypja e perandorit, të gjithë peshkopët në përjashtim të dyve, nënshkruan kredon, e cila për shumicën ishte kundër tendencave të tyre.

Konstandini e konsideroi vendimin e Nikesë si frysëzim hyjnor. Për aq kohë sa ai jetoi, nuk guxonte askush haptazi të sfidojë Kredon e Nikesë; por marrëveshjen e shumëpritur nuk e patën ndjekur. (16)

Kredoja e Nikesë

Ne besojmë në një Perëndi, Të Atin Sunduesin Absolut, krijuesi i të gjithë sendeve të dukshme dhe të padukshme; dhe në një Zot Jezu Krishtin, Të Birin e Perëndisë, i linduri nga i Ati, i linduri i vetëm i Tij, që është i të njëjtës substance sikur Zoti Atë, Zot nga Zoti, Dritë nga Drita, Zot i vërtetë nga Zoti i vërtetë, i lindur e jo i krijuar, i të njëjtës substance me Atin, nëpërmes të cilës u krijuua çdo gjë, ç'ka në quell dhe ç'ka në tokë; i cili për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti në tokë dhe u bë nga mishi, u bë nga lloji njerëzor, vuajti, dhe u ringjall në ditën e tretë, u ngrit për në qiej, dhe do të vij për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit. Dhe besojmë në Shpirtin e Shenjtë, Dhe ata që thonë 'Ishte atëherë kur ai nuk ishte' dhe 'Përpara se të ishte lindur ai nuk ishte' dhe se 'Ai erdhi në ekzistencë nga gjësind që nuk ishte'; apo ata që pretendojnë se biri i Zotit është 'I një substance apo esence tjetër' Apo 'I krijuar', Apo 'I ndërrueshëm' Apo 'I ndryshueshëm' Këta shkishërohen (mallkohen) nga ana e Kishës Katolike dhe asaj Apostolike.

Kredoja 'Nikea'

Bettenson shpjegon Kredon 'Nikea' si në vijim:

[Ishte] e gjetur në Epiphanius, Ancoratus, gjatë viteve 118-

374, dhe e nxjerrur nga dijetarët, pothuajse fjalë për fjale, nga ligjeratat katekistike të Shën Qirilit të Jerusalemit; të lexuara dhe të aprovuara në Chalcedon, në vitin 451, si kredo e (318 etërvë të cilët u takuan në Nike) dhe e 150 të tjerëve të cilët u takuan më vonë (d.m.th. në Konstandinopojë, 381). Qysh atëherë shpesh quhet Kredoja Konstandinopojane ose Nikejo-Konstandinopojane, dhe mendohet nga shumica që besohet të jetë korrigjim i kredos së Jerusalemit e mbajtur nga Qirili.

Ne besojmë në një Perëndi Atin Sunduesin Absolut, krijuesin e qiejve dhe tokës, dhe të gjitha gjërave të dukshme dhe të padukshme.

Dhe në një Zot, Jezu Krishti, i linduri i vetëm i Perëndisë, i lindur nga Ati përpara gjithë epokave, Dritë nga Drita, Zot i vërtetë nga një Zot i vërtetë, i lindur e jo i bërë, nga një substancë me Atin, me anë të cilit janë bërë të gjitha gjërat; i cili për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë zbriti nga qiejtë dhe u bë nga mishi, nga Shpirti i Shenjtë dhe nga Virgjëresha Mari, dhe u bë njeri, dhe u kryqëzua për ne në kohën e sundimit të Pontius Pilate, përjetoi vuajtje, u varros dhe u ringjall të tretën ditë sipas shkrimeve të shenja biblike. U ngrit në qiej dhe i ulur në krahun e djathtë të Atit dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë fund:

Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zoti dhe Dhuruesi i jetës, i cili doli nga Ati, adhurohet dhe përlëvdohet me Atin dhe Birin sëbashku, i cili foli me anë të profetëve:

Në një kishë të shenjtë katolike dhe apostolike:
Ne pranojmë një pagëzim për faljen e mëkateve. Ne presim ringjallje të të vdekurve dhe jetën për në epokën e ardhshme. (17)

Megjithëse Këshilli i peshkopëve e pranoi Kredon e Nikesë, nuk përmendej askund Triniteti.

Polemika mbi natyrën e Jezusit vazhdoi për disa dekada. Në vitin 381, u mbajt këshilli i dytë i përgjithshëm në Konstandinopojë. (18) Ky këshill miratoi Kredon e Nikesë duke deklaruar se Jezusi dhe Zoti janë të barabartë dhe të përbashkët në përjetësi dhe shpalli hyjninë e Shpirtit të Shenjtë. Doktrina e Trinitetit u themelua zyrtarisht si gurthemeli i besimit krishterë për pesëmbëdhjetë shekujt e ardhshëm.

Shënim: Sikur që është "Lutja e Zotit" në (Mateu 6:9-13), të gjithë katolikët romakë janë të detyruar që ta përkujtojnë "Kredon e Nikesë", duke e shtuar atë në lutjet e tyre.

Perandori Theodosius e bëri besimin në Krishterizëm çështje të urdhërit perandorak:

"Kjo është dëshira ynë, të gjithë njerëzit të cilët i udhëheqim ta praktikojnë këtë fe të cilën Pjetri hyjnor Apostulli ua kumtoi romakëve.

Ne do të besojmë në Hyjninë e vetme të Atit, të Birit, dhe të Shpirtit të Shenjtë, sipas konceptit të madhështisë së barabartë dhe të Trinisë së Shenjtë.

Ne urdhërojmë që ata persona të cilët ndjekin këtë rregull do ta përvetësojnë emrin 'të krishterë katolikë'. Kurse të tjerët, të cilët ne i konsiderojmë të çmendur dhe të marrë, do të mbajnë turpin e dogmave heretike, vendtakimi i tyre nuk do të marrë emrin e kishave, dhe ata do të jetë të goditur me sprova së pari me anë të hakmarrjes hyjnore dhe së dyti me ndëshkim nga vetë iniciativa jonë. Ne do të marrim përsipër gjithçka që është në përputhje me gjykimin hyjnor." (19)

Më vonë, u themelua doktrina e nderimit të Marisë si "nëna e Zotit" dhe "mbartësja e Zotit", edhe atë në Këshillin e Dytë të Konstandinopojës, në vitin 553, si dhe ju shtua titulli "Virgjëresha e Përjetshme". "Në lutjet dhe himnet e Kishës Ortodokse ishin duke thirrur emrin e nënës së Zotit aq

shpesh sa ishin duke thirrur edhe emrin e Krishtit dhe Trininë e Shenjtë"..."Në doktrinën katolike romake, Maria, nëna e Zotit, u identifikua në formë të Urtësisë hyjnore. Procesi i hyjnizimit të nënës së Zotit shkoi një hap më tej, ngaqë Maria u trajtua si një hipostazë (substancë) hyjnore, në formë të Urtësisë hyjnore." (20)

Faktorët që ndikuan në doktrinën e Trinitetit

Faktorët që ndikuan në formulimin e doktrinës së Trinitetit janë të përbledhura nga shoqata 'Watchtower' dhe 'Bible Tract Society of Pennsylvania', në vitin 1989, e cila konsiderohej lajmëtare paraprijëse e doktrinës së Trinitetit:

Gjatë kohëve të lashta, qysh nga Babilonia, adhurimi paganë i perëndive, duke i grupuar në treshe ishte një gjë e zakonshme. Kjo praktikë gjithashtu ishte e përhapur edhe më parë, gjatë dhe pas Krishtit në Egjipt, Greqi dhe Romë. Pas vdekjes së apostujve, besimet e tilla pagane filluan që ta invadojnë Krishterimin.

Historiani Will Durant e vërejti këtë gjë dhe tha: "*Krishterimi nuk e ka shkatërruar paganizmin, por e ka adoptuar atë... Nga Egjipti erdhën idetë e trinisë hyjnore.*" Dhe në librin e religionit egjiptian, Siegfried Morenz thekson:

"Triniteti ishte një preokupim kryesor i teologëve egjiptian... Tre zota janë të bashkuar dhe të trajtuar si një qenie e vetme, duke iu drejtuar në njëjës. Në këtë mënyrë forca shpirtërore e religionit egjiptian tregon një lidhje direkte me teologjinë krishtere. Andaj, në Aleksandri, kishtarët e Egjiptit të cilët i takojnë fundit të shekullit të tretë dhe fillimit të shekullit të katërt, siç është Athanasius, reflektuan këtë ndikim ashtu siç i kishin formuluar idetë që çojnë në Trinitet. Përhapja e tyre influente arriti aq shumë sa që Morenz e konsideron teologjinë e Aleksandrisë si ndërmjetësues në

mes të trashëgimisë religjioze egiptiane dhe Krishterimit."

Në Enciklopedinë e Religjioneve dhe Etikës, James Hasting shkroi: "Në *religjionin Indian, p.sh., hasim në grupimin e trinitarë të Braham, Siva, dhe Visnu; në religjionin egiptian grupin trinitarë të Osiris, Isis, dhe Hourus...nuk e hasim këtë vetëm në historinë e religjioneve që Zotin e shohin si një Trini. Por, përmendet në veçanti pikëpamja e re platonike e Realitetit Suprem dhe Absolut i cili paraqitet në formë treshe.*"

Enciklopedia e re Schaff-Herzog për njojuri dhe dituri të religjioneve dhe feve tregon se sa ka ndikuar kjo filozofi greke, duke thënë: "*Doktrinat e Logosit dhe Trinitetit e morrën formën e tyre që kanë nga etërit grek, të cilët... ishin të ndikuar së tepërti, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, nga filozofia platonike. Këto gabime dhe korruptime janë zvarritur deri te kisha nga ky burim i cili nuk mund të mohohet.*"

Kisha e tre shekujve të parë thotë:

"Doktrina e Trinitetit ishte një formim gradual dhe relativisht i vonshëm;...ajo kishte origjinën e vet në një burim krejtësisht të huaj nga ai i shkrimeve të shenjta hebraike dhe krishtere;... ai u rrit dhe u transplantua në Krishterim, nëpërmes duarve të etërve të platonizuar." (21)

Skulptura e zotave me tre ftyra është gjetur në disa pjesë të botës (p.sh., Kampuchea, [Zoti trinjësor budist, shekulli i 12-të]; Itali, [Triniteti, shekulli i 15-të]; Norvegji, [Triniteti (Ati, Biri, Shpirti i Shenjtë), shekulli i 13-të]; Franca, [Triniteti, shekulli i 14-të]; Gjermani, [Triniteti, shekulli i 19-të]; Indi, [Zoti trinjësor i Hindus, shekulli i 7-të]; S. Falmyra, [Trinjësimi i zotit të hënës, zotit të qiejve, zotit të diellit, shekulli i 1-rë]; Babiloni, [Trinjësimi i Ishtar, Sin, Shamash, mileniumi i 2-të p.e.s] dhe Egjipt, [Trinjësimi i Horus, Osiris, Isis, mileniumi i 2-të p.e.s]). (22)

Justifikimi i doktrinës së Trinitetit nga ana e trinitarëve

Gjigantët e Krishterimit, në një përpjekje për të shpëtuar Trinitetin, provuan të gjitha mjetet që patën në dispozicion për të justifikuar doktrinën. Megjithatë, pas shpalosjes së të gjitha argumenteve të njohura logjike dhe arsyes njerëzore, dështuan tmerrshëm dhe deklaruan se është një "**MISTER**". Në vijim janë disa nga deklaratat e dhëna nga krerët e Kishave, teologët e shquar krishterë, shkrimtarët e njohur të cilët erdhën me hov të madh për ta mbrojtur atë guximshëm:

"Trinia e shenjtë është një mister në plot kuptimin e fjalës. Vetem arsyaja e shëndoshë dhe logjika nuk mund ta vërtetojë ekzistencën e një Zoti trinjësor, shpallja hyjnore na e mëson atë. Madje edhe pas shfaqjes së këtij misteri, përsëri mbetet e pamundur për intelektin e njeriut që ta kuptojë se si mundet që Tre Personat të kenë një Natyrë Hyjnore". (23)

Dijetarët katolikë Karl Rahner dhe Herbert Vorgimler në fjalorin e tyre teologjik citojnë: "Triniteti është një mister... në plot kuptimin e fjalës..., i cili nuk mund të njihet pa shpallje hyjnore, madje edhe pas ardhjes se shpalljes nuk mund të bëhet tërësisht i kuptueshëm."

"Një dogmë kaq misterioze që presupozon të jetë shpallje Hyjnore." (Enciklopedia Katolike)

"Zoti është një dhe Zoti është tre. Meqë nuk ka gjë që është sikur kjo në krijesat, atëherë ne nuk mund ta kuptojmë atë, por vetëm që duhet ta pranojmë atë." (Imzot Eugene Clark)

"Ne e dimë se ai është një mister shumë i thellë, të cilin akoma nuk kemi filluar që ta kuptojmë." (Kardinali John O'Connor)

"Misteri i padepërtueshëm (enigmatik) për çështjen e Zotit është Triniteti." (Papa Gjon Pali II) (24)

Doktrina e Trinitetit nuk është mësuar nga të krishterët e hershëm

Shprehja "Zoti Atë", "Zoti Birë" dhe "Zoti Shpirti i Shenjtë" nuk janë vetëm sinonime për krishterimin, por janë edhe thelbi i besimit krishter.

Megjithatë, ky besim që konsiderohet si shatërvani i fesë krishtere nuk ishte i njohur apo i përkrahur nga Jezusi a.s. ose nga të krishterët e hershëm. Etërit apostolik dhe gjeneratat që erdhën pas deri në çerekun e fundit të shekullit të 4, nuk kanë menduar kurrë për një Zot në trinjësi. Ata besonin në Një Të Plotfuqishmin, Ai që ka mundësi të bëjë çdo gjë, I Gjithëdiçshmi, Krijuesi i Përsosur, i cili është I Vetmi që duhet të adhurohet.

Raportimet e mëposhtme autentike të nxjerra nga autoritete të ndryshme krishtere flasin vetë:

"Formulimi 'Një Zot në tre persona' nuk ishte i vendosur fuqishëm në jetën e të krishterëve dhe në besimin krishter, para përfundimit të shekullit të 4. Por, pikërisht ky formulimi është pretendimi i parë për emërtimin e dogmës Trinitare. Midis etërve apostolik nuk ka pasur kurgjë, s'ka patur ndonjë gjë i afron, qoftë edhe për së largëti në mentalitet apo perspektivë." (25)

Doktrina e Trinitetit është shpikur nga të krishterët rreth treqind vjet pas Jezusit. Të katër ungjijtë kanonikë, të shkruar gjatë viteve 70 dhe 115 të erës sonë, nuk përmbajnë asnjë referencë në lidhje me Trinitetin. Edhe Shën Pali, i cili ka importuar shumë ide të huaja në Krishterizëm, nuk dinte kurgjë për Zotin Trinjësor. Enciklopedia e re katolike (e cila mbart miratimin zyrtar) pranon se doktrina e Trinitetit ishte e panjohur për të krishterët e hershëm dhe se është formuluar në çerekun e fundit të shekullit të 4:

"Nëse është e vështirë, që në gjysmën e dytë të

shekullit 20 të ofrojmë një shpjegim të qartë, objektiv dhe të drejtë për shpalljen (revelatën), vlerësimin doktrinar, elaborimin teologjik për misterin e Trinitetit. Diskutimet e Trinitarëve, Katolikët Romak si dhe të tjerë, paraqesin një siluetë disi të pasigurtë dhe të paqëndrueshme.

Dy gjëra kanë ndodhur. Ka njohje nga ana e ekzegjetëve dhe teologëve biblik, ndër tjerash përfshihet edhe një rritje e vazhdueshme e numrit të katolikëve romak, andaj nuk duhet askush të flasë për Trinitarizmin në Dhjatën e Re pa patur aftësi të madhe. Poashtu ka një njohje të afërt paralele nga ana e historianëve të dogmës dhe teologëve sistematik se kur fol në lidhje me Trinitarizmin një i paaftë, i cili është nisur në lëvizje nga periudha e origjinës së krishterëve, të themi se është në çerekun e fundit të shekullit të 4. Ajo ishte vetëm atëherë, ajo që mund të quhet Dogma definitive trinitare 'Një Zot në tre persona', e cila u përvetësua tërësisht në jetën e të krishterëve dhe mendimin e tyre." (26)

"Në fillim besimi krishter nuk ishte Trinitar ... Po as që ishte në kohën apostolike dhe nënapostolike, siç pasqyrohet në Dhjatën e Re dhe në shkrime të tjera të hershmë krishtere." (Enciklopedia e Religjionit dhe Etikës)

"Të krishterët e hershëm, megjithëse nuk e bënë në fillim aplikimin e idesë së Trinitetit në besimin e tyre, ata i drejtuat lutjet e tyre te Zoti Atë dhe te Jezu Krishti, i Biri i Zotit, dhe ata e njohën... Shpirtin e Shenjtë; por nuk kishte asnjë mendim që këta të tre të jenë në Trini reale, të barabartë dhe të bashkuar në Një." (Paganizmi në Krishterizmin tonë) (27)

A flet Bibla për doktrinën e Trinitetit?

Përderisa Bibla është predikuar dhe besohet si Fjala e Zotit, ajo nuk përbën doktrinën e njohur të Trinitetit. Nëse kjo doktrinë e Trinitetit ishte e vërtetë, ajo do të duhej të ishte e paraqitur qartë në Bibël, sepse ne kemi nevojë që ta njohim Zotin dhe mënyrën si ta adhurojmë Atë.

Asnjë nga radhët e profetëve të Zotit, nga Ademi a.s. deri te Jezusi (Isai) a.s., nuk e ka mbajtur konceptin e Trinitetit apo Zotin trinjësor. Asnjë i dërguar i Zotit nuk ka folur ndonjë deklarim të fshehur në lidhje me këtë çështje, apo të ketë ndonjë referencë në Bibël, qoftë në Dhjatën e Vjetër apo atë të Re, që e konfirmon një doktrinë të tillë. Andaj, është i çuditshëm fakti që as Jezusi a.s. e as dishepujt e tij nuk kanë folur për Trinitetin në Bibël. Përkundrazi, Jezusi a.s. thotë: "Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot." (Marku 12:29, Bibla)

Sipas Shën Palit: "*Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë: Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë të ti tij, siç edhe vet e dini.*" (Veprat e Apostujve 2:22, Bibla)

Vargjet e mësipërme biblike flasin për veten. Pse duhet të vijë ndokush dhe të shkaktojë shqetësim dhe mërzi me anë të një doktrine plotë konfuzione dhe hutime, ndërkohë që dijetarët krishterë që i takojnë eminencës më të lartë nuk janë në gjendje për ta interpretuar apo shpjeguar atë kuptueshëm?

Jezusi a.s. e ka profetizuar (parashikuar) drejtë këtë farë problemi në (Mateu 15:8-9, Bibla): "*Ky popull po më afrohet me gojë dhe më nderon me buzët; por zemra e tyre rri larg meje. Dhe më kot më nderojnë, duke i mësuar doktrina që janë urdhërime nga njerëzit.*"

Përveç kësaj, pasuan fjalët e Shën Palit në (2 e Timoteut 4:3-4, Bibla): "*Sepse do të vijë koha kur njerëzit nuk do ta durojnë doktrinën e shëndoshë, por, sipas éndjeve të veta, do të mbledhin grumbull mësues për të gudulisur veshët dhe do t'i largojnë veshët nga e vërteta e do t'i sjellin drejt përrallave.*"

Më tej gjithashtu lexojmë në (Titit 1:16, Bibla): "*Ata pohojnë*

se njojin Perëndinë, po me vepra e mohojnë, sepse janë të neveritshëm, të pabindur dhe të pazotë për çfarëdo vepre të mirë.

Në vazhdën e kësaj dileme, mendjet e mëdha në mesin e të krishterëve përdorën të gjitha mjetet e njoitura logjike që të sjellin besueshmëri në doktrinën e Trinitetit, por dështuan tmerrësishët dhe më pas deklaruan për atë të ketë qenë një mister. Megjithatë, adhurimi i Zotit të Plotfuqishëm nuk mund të kompromentohet. Ai dëshiron që njeriu ta adhurojë vetëm Atë në përputhje me udhëzimin e Tij Hyjnor. Nga fakti që Ai është vetë i Drejtë, vijon që drejtësia e Tij kërkon që mesazhi i Tij duhet patjetër të jetë i qartë dhe në formë të thjeshtë. Mësimet e këtij mesazhi hyjnor, në tërësi, të jenë të liruar nga çdo paragjykim, e metë dhe konfuzion. Ajo duhet të jetë një e vërtetë absolute që gjithmonë mund të përballojë sfidën e çfarëdo lloji të njojurive duke përfshirë edhe zbulimet njerëzore në fushën e shkencës. Që nga koha kur doktrina e Trinitetit dihet të jetë një "mister" në vete, si e tillë, nuk mund të konsiderohet si një frymëzim hyjnor. Bibla thotë: "*Sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi si në të gjitha kishat e shenjtorëve.*" (1 e Korintasve 14:33, Bibla)

Rreth Shkrimeve hebraike

Enciklopedia e Religjionit pranon se:

"Teologët sot janë dakord se Bibla hebraike nuk përmban doktrinën e Trinitetit". Dhe Enciklopedia e re katolike gjithashtu thotë: "Doktrina e Trinitetit të Shenjtë nuk është e përmendur në mësimet e Dhjatës së Vjetër".

Ngjashëm pohon jezuiti Edmund Fortman në librin e tij 'The Triune God' - (Zoti trinjësor) ku thotë: "*Dhjata e Vjetër... nuk na tregon neve asgjë në mënyrë eksplikite apo që nënkupton me domosdoshmëri një Zot Trinjësor, e që është Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë... Nuk ka asnje dëshmi se ndonjë shkruesi fjalëve të shenjta ndonjëherë të ketë dyshuar në ekzistencën e një Triniteti Brenda Hyjnisi... Por*

kur shihen në Dhjatën e Vjetër sugjerime apo paralajmërimë apo 'shenja të fshehta' të trinitetit të personave, kjo paraqet një dalje përtej fjalëve dhe qëllimit që ka patur shkruesi i shkrimeve të shenja". (28)

Rreth Shkrimeve greke

Enciklopedia e Religjionit thotë: "Teologët janë dakord se Dhjata e Re gjithashtu nuk përmban një doktrinë eksplikite të Trinitetit."

Jeziuti Forman citon: "Shkruesit e Dhjatës së Re... nuk na jasin asnjëfarë doktrine formale apo të formuluar të Trinitetit, nuk ka asnjë mësim të qartë që thotë se në një Zot ka tre persona hyjnorë të barabartë... Askund nuk gjejmë ndonjë doktrinë trinitare të tri subjekteve të dalluara që kanë jetesë dhe veprimtari hyjnore në të njëjtën Hyjni."

Fjalori i ri ndërkombëtar i Teologjisë së Dhjatës së Re, ngjashëm citon: "Dhjata e Re nuk përmban doktrinën e zhvilluar të Trinitetit. 'Në Bibël mungojnë deklaratat e shprehura se Ati, Biri, dhe Shpirti i Shenjtë janë të një esence të barabartë.'" [kështu thotë teologu protestant Karl Barth].

Historiani Arthur Ëeigall shënon: "Jeu Krishti kurrë nuk përmendi një fenomen të tillë, dhe askund në Dhjatën e Re nuk shfaqet fjalë 'Trinitet'. Ideja vetëmse që ishte e përvetësuar nga ana e Kishës treqind vjet pas vdekjes së Zotit tonë (Krishtit)." [marrur nga libri "Paganizmi në Krishterizmin tonë"] (29)

Hedhja poshtë e dotrinës së Trinitetit nga të krishterët modern

Shumë teologë krishterë modern refuzojnë që t'i përbahen doktrinës së themeluar nga ana e Kishave. Njëri nga më të shqarit dhe të fundit prej atyre teologë është peshkopi i ri i Dubanit, Peshkopi David Jenkins, profesor i Teologjisë dhe Studimeve Religjioze në Universitetin e Leeds, i cili thotë se disa ngjarje në misionin

e hershëm të Jezusit: "Nuk ishin në mënyrë strikte të vërteta, por ishin të shtuara në historinë e jetës së Jezusit nga ana e krishterëve të parë për të shprehur besimin e tyre që kishin në të si një Mesia." (30)

Prof. John Hick thotë: "Atë çka e zhvilloi ortodokzia që dy natyrat e Jezusit, hyjnore dhe njerëzore duke trashëguar bashkërisht një personalitet historik të Jezu Krishtit, i cili mbetet një formë e fjalëve me kuptime që nuk mund të përcaktohen." Ai më tej thotë: "Për të thënë, pa ndonjë shpjegim, se Jezusi historik i Nazaretit ishte gjithashtu Zot, fjalë kjo që i mungon kuptimi, sikur të thuash se ky rrethi i vizatuar me laps në letër është gjithashtu një kator. Një lokucion i tillë duhet të japë përmbajtje semantike dhe në rastin kur e ka kuptimin gjuhësor të inkarnacionit (mishërimi) duhet të hedhet poshtë çdo kuptim i sugjeruar deri më tani." Ai vazhdoi të sugjeronte se **mishërimi hyjnor** **është një ide mitologjike**. Përsëri ai tha: "Unë jam duke e përdorur termin 'mit' në kuptimin që vijon - "miti është një ngjarje historike e cila rrëfehet por nuk është e vërtetë fjalë për fjalë, apo një ide ose imazh që është aplikuar ndaj dikujt apo diçkaje, e që fjalë për fjalë nuk aplikohet." dhe se "Jezusi ishte Zoti Bir i mishëruar nuk është e vërtetë fjalë për fjalë, përderisa nuk ka kuptim të fjalëpërfalshëm, por është një aplikim ndaj Jezusit nga një koncept mitologjik, funksioni i të cilit është analog me atë të nacionit të birësisë hyjnore që i atribuohej në kohët e lashta një mbreti." (31)

Fjalët e Victor Paul Wierwille në librin e tij 'Jezi Krishti nuk është Zot': "Unë jam duke thënë se Jezi Krishti nuk është Zot, por është Biri i Zotit. Ata kanë përjetësi të përbashkët pa fillim e pa mbarim, e as që kanë barazi të përbashkët. Jezi Krishti nuk ishte me Zotin që në fillim në kuptimin fjalë për fjalë, e as që i ka të gjitha cilësitë e Zotit." (32)

Komenti empatik i Victor Paul Wierwille: "Para se ta mbyll fjalën, më lejoni ta nxjerr në shesh atë që më flen në shpirt. Nëse them se Jezi Krishti nuk është Zot, nuk do të thotë se

në mendjen time e degradoj rëndësinë dhe domethënien e Jezu Krishtit në asnë mënyrë. Thjeshtë e lartëson Zotin, Atin e Jezu Krishtit, në pozitën e Tij unike, madhështore dhe të pashembullt. Vetëm Ai është Zot." (33)

Unë besoj se Jezusi a.s. ishte krijuar nga Zoti; se ai ishte "Mesia" (i vajosuri, i mirosur) dhe i Dërguari i Zotit; se ai ishte fjala e Zotit që ia përçolli Marisë (Merjemes) dhe një shpirt nga ana e Tij. Unë nuk e pranoj atë si Zot ose Zoti i Mishëruar, as si Bir i Zotit e as si Zoti Bir. Zoti dhe Jezusi a.s. janë të ndryshëm dhe janë qenie të ndara (veçuara). Zoti është Krijuesi dhe Jezusi a.s. ishte qenie e krijuar. Ata janë të substancave të ndryshme dhe të pabarabarta në kohë, fuqi, dije dhe pozitë.

Deklaratat e shumta kategorike të Jezusit dhe ato të profetëve të mëparshëm të Zotit s.a.v.s., të gjetura në Bibël anulojnë dy konceptet, atë të "Mishërimit të Zotit" dhe të "Doktrinës së Trinitetit". Çfarëdo që është në kundërshtim me deklaratat e mia nuk është asgjë tjetër pos thashetheme të bëra nga individë të cilët kanë nevojë për të mbështetur pretendimet e tyre. Dëshmitë që ata kanë në dorë janë ndërshtierjet më të mira që janë futur ngadalë në Ungjillin origjinal të Jezusit a.s. dhe mesazheve të mëparshmë të Zotit. **"Jezusi a.s. nuk është Zot, por vetëm një profet i madh dhe i dërguar i Zotit."**

Mësimet e Profetëve të Zotit

Çuditërisht, asnë nga profetët para ose pas Jezusit a.s. nuk ka mësuar doktrinën e Trinitetit. Përkundrazi, ata shpallën Njëshmërinë e Zotit. Vetëm Zoti është i Përsosuri mbi gjithëçka që ekziston. Ai është i Plotfuqishmi dhe Krijuesi i çdo gjëje që shihet dhe që nuk shihet, e nuk ka as pjesmarrës, ortak apo bashkëpunëtor në sundimin e Tij, nuk ka as familje, pasardhës apo ndihmës në Hyjninë e Tij. Ai është i vetmi Furnizues dhe Mbrojtës i gjithë krijesave. Këto

që vijojnë përbëjnë mësimet e profetëve të Zotit:

Profeti Mojsej (Musa) a.s. thotë: "Tani e di që Zoti është më i madhi nga tërë perënditë; po, ai ua vërtetoi atyre me sa krenari, kur vepruan me kryelartësi kundër Izraelit". (Eksodi 18:11, Bibla)

"Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm. Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde. Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde; do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh. Do t'i lidhësh si një shenjë në dorë, do të jenë si shirita midis syve, dhe do t'i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate dhe mbi portat e tua." (Ligji i Përtërirë 6:4-9, Bibla)

"Ruhuni se harroni besëlidhjen që Zoti, Perëndia juaj, ka lidhur me ju, dhe bëni ndonjë shëmbëlltyrë të gdhendur në trajtën e çfarëdo gjëje që Zoti, Perëndia yt, e ka ndaluar. Sepse Zoti, Perëndia yt, është një zjarr që të konsumon, një Zot ziliqar." (Ligji i Përtërirë 4:23-24, Bibla)

Koncepti i njëjtë i Zotit është konfirmuar nga Jezusi a.s. (Marku 12:29, Bibla) "...Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot..." Të dy profetët (paqja qoftë mbi të gjithë profetët) theksuan prerazi çështjen se Zoti i tyre dhe Zoti ynë është Një Zot. Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se nuk ka asgjë në deklaratat e tyre që tregon se dikush prej atyre ka marrë pjesë në Hyjnинë.

"Nuk ka asnë të shenjtë si Zoti, sepse nuk ka asnë tjetër vëç teje, nuk ka asnë shkëmb si Perëndia ynë." (1 i Samuelit 2:2)

Profeti David (Davud) a.s. në Psalmet e Biblës thotë: "dhe ta dijnë se ti vetëm, që quhesh Zoti, je Shumë i Larti mbi gjithë dheun." (Verseti 83:18); "Beko, o shpirti im, Zotin! O Zot, Perëndia im, ti je jashtëzakonisht i madh; je veshur me

shkëlqim dhe madhështi." (Verseti 104:1); "Ai është Zoti, Perëndia ynë." (Verseti 105:7); "Zoti është Perëndia dhe ka bërë që mbi ne të shkëlqejë drita e tij." (Verseti 118:27); "Ti je Perëndia im, unë do të të kremtoj; ti je Perëndia im, unë do të të përlëvdoj." (Verseti 118:28).

Profeti Solomon (Sulejman) a.s. thotë: "*Frika e Zotit është parimi i diturisë, dhe njohja e të Shenjtit është zgjuarsia.*" (Fjalët e urta 9:10, Bibla)

Edhe këto fjalë zakonisht janë atribuar profetit Solomon a.s.: "*Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut.*" (Predikuesi 12:13, Bibla)

Profeti Isaia a.s. thotë: "*Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës...*". (Isaia 40:28, Bibla)

Definitivisht, vetëm Krijuesi është Zot, Ai i Cili krijoi gjithçka (gjithë universin dhe çka ka në të) mijëra vite më parë përpara ardhjes së Jezusit a.s. Vetë Jezusi ishte i krijuar nga Zoti dhe po kështu edhe Shpirti i Shenjtë. Në fakt, nuk ekzistonte Triniteti deri atëherë kur u shpik dhe u formulua nga njerëzit në shekullin e 3-të pas lindjes së Krishtit.

"...Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm Atij." Jezusi a.s. me anë të ketij urdhërimi deklaroi dhe pohoi se nuk meriton askush tjetër të adhurohet përvèç Zotit Një. (Mateu 4:10 dhe Luka 4:8, Bibla)

Profeti Jezusi a.s. thotë: "*Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.*" (Gjoni 17:3, Bibla)

Deklaratat e mësipërme të Jezusit a.s. vërtetojnë se ka vetëm një person Hyjnor " **të vetmin Perëndi të vërtetë**" dhe se ai nuk dinte asgjë për Trinitetin. Përvèç kësaj, Jezusi a.s. nuk solli asnjë pretendim të shpallë veten Zot, sepse ai iu referua një qenie "Ty" që e pranoi si një të vetmin Zot,

Hyjni tē vërtetë kurse veten e tij vetëm një i dërguar i Zotit d.m.th. me fjalët "...dhe atë që dërgove, Jezu Krishtin."

Shën Pali ka qenë në dijeni dhe ka qenë i vetëdijshëm për ekzistencën e Trinitetit. Ai thotë: "Burra tē Izraelit, dëgjoni këto fjalë: Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra tē fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë tē ti tij, siç edhe vet e dini." (Veprat e Apostujve 2:22, Bibla)

"Sepse, ndonëse ka tē ashtuquajtura perëndi në qiel a në tokë (sikurse ka shumë perëndi dhe shumë zotër), për ne s`ka veçse një Perëndi, Ati nga i cili janë tē gjitha gjërat dhe ne në tē...". (1 e Korintasve 8:5-6, Bibla)

"Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbetjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur." (El-Bekare 2:136, Kur'ani)

"Ne patëm dërguar Nuhun te populli i vet, e ai i tha: "O populli im, adhuroni vetëm All-llahun, nuk keni zot tjetër pos Tij. Unë kam frikë për dënimin Tuaj në një ditë tē madhe!"" (El-A'raf 7:59, Kur'ani)

"E Ibrahimi i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe Jakubi, (u thanë) "O bijtë e mi, All-llahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!"" (El-Bekare 2:132, Kur'ani)

"Ibrahimi nuk ka qenë as jehudi as i krishterë, por ai ishte larg besimeve tē kota, ishte musliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve." (Ali-Imran 3:67, Kur'ani)

"A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: "Çka do të adhuroni pas meje"? Ata thanë: "Do të adhurojmë Zotin tënd, dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Një të Vetmin Zot dhe ne, vetëm Atij i jemi dorëzuar!"" (El-Bekare 2:133, Kur'ani)

"Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, e ai tha: "O populli im, adhuronie (një Zot) All-llahun, ju nuk keni zot pos Tij, a nuk po frikësoheni?!" (El-A'raf 7:65, Kur'ani)

"Edhe te (populli) i Themudit u dërguam vëllain e tyre, Salihun, e ai ju tha: "O populli im, besonie All-llahun (një) nuk keni zot tjetë pos Tij..." (El-A'raf 7:73, Kur'ani)

"E në Medjen (dërguam) vëllain e tyre Shuaibin. Ai tha: "O populli im, adhuronie All-llahun (një), ju nuk keni zot tjetër pos Tij..." (El-A'raf 7:85, Kur'ani)

"E Haruni atyre u pat thënë më parë: "O populli im, ju vetëm u sprovuat me të, pse Zoti juaj është i Gjithëmëshirshmi, andaj ejani pas meje dhe më dëgjoni përkëtë që po ua thëm". (Taha 20:90, Kur'ani)

"(Përkujto) Edhe Ejubin kur iu drejtua Zotit të vet me lutje: "Më gjeti belaja, e Ti je më Mëshiruesi ndër Mëshiruesit!" (El-Enbiya 21:83, Kur'ani)

"Ne i patëm dhënë Davudit dhe Sulejmanit dituri, e ata të dy thanë: "I falënderohemi vetëm All-llahut që na dalloj (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë". (En-Neml 27:15, Kur'ani)

"E Sulejmani e trashëgoi Davudin dhe tha: "O njerëz, ne kuqtojmë gjuhën e shpendëve e na është dhuruar nga gjithçka, e vërtet ky është shpërblim i qartë". (En-Neml 27:16, Kur'ani)

"(Përkujto) *Edhe Zekirijain kur e luti Zotin e vet: "Zoti im, mos më lë të vëtmuar se Ti je më i miri trashëgues (pas çdokujt)". Ne ia pranuam lutjen e tij, ia dhuruam atij Jahjain dhe ia përmirësuam bashkëshorten atij...*" (El-Enbija 21:89-90, Kur'ani)

Profeti Jezus (Isai) a.s. thotë: "*All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Adhurojeni Atë; kjo është rrugë e drejtë!*" (Ali Imran 3:51, Kur'ani)

Kur është pyetur profeti Muhamed s.a.v.s. nga një njeri që t'i tregojë një vepër e cila do ta bënte që të hyjë në Parajsë (Xhennet), ai i tha: "Të adhurosh Allahun Një e të Vetëm dhe të mos adhurosh tjetër përpos Atij..." (Buhariu, Thëni e Profetit Muhamed s.a.v.s.)

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nëse dikush dëshmon se nuk ka zot tjetër (që meriton të adhurohet), përveç Allahut Një e të Vetëm; se Muhamedi a.s. është rob dhe i Dërguari i Tij; se Isai a.s. është rob i Zotit, i Dërguari i Tij, Fjala e Tij e hedhur te Merjemja dhe shpirt i krijuar prej Tij; se Xheneti është i vërtetë dhe se Xhehenemi është i vërtetë - Allahu do ta pranojë atë në Xhenet me ato veprat që ka bërë." (Buhariu, Thëni e profetit Muhamed s.a.v.s.)

Në një hadith tjetër autentik Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Kushdo që vdes duke mos adhuruar askënd tjetër përpos Allahut, do të hyjë në Xhenet.*" (Buhariu, Thëni e profetit Muhamed s.a.v.s.)

Transmetohet nga Ibn Abbasi r.a.: Një ditë isha pas Pejgamberit (a.s) dhe më tha: "O bir im, po t'i mësoj disa fjalë: *Ruaje Allahun (bindu Atij), e Ai do të ruaj ty. Ruaje Allahun (bindu Atij), e Atë do ta gjesh gjithmonë pranë teje. Në qoftë se kërkon diçka, kërko vetëm prej Allahut. Në qoftë se kërkon ndihmë, kërko vetëm tek Allahu. Dije mirë se, sikur i gjithë njerëzimi të mblidhen për të bërë dobi*

ndonjë send, nuk do kenë mundësi të bëjnë dobi, përveç me aq sa ta ka shkruar Zoti ty dhe sikur ata të mblidhen për të dëmtuar, nuk do të kenë mundësi të të dëmtojnë, përveç me aq sa ta ka shkruar Zoti ty. Çdo gjë është e vendosur nga ana e Allahut në kader (përcaktimin e Tij)". (Tirmidhiu, Thëni e profetit Muhamed s.a.v.s.)

Në një thënie tjetër të profetit Muhamed s.a.v.s. thuhet: "Allahu nuk do t'i dënojë njerëzit për mëkatet e tyre, përveç atyre të cilët tregohen të padëgjueshëm, mospërfillës, kundërshtues ndaj Allahut dhe atyre të cilët nuk pranojnë të besojnë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut." (Thënie të profetit Muhamed s.a.v.s.) (34)

"Jezusi nuk ishte një i krishterë; ai ishte një çifut. Ai nuk predikonte një besim të ri, por i mësoi njerëzit që të veprojnë në përputhshmëri më vullnetin e Zotit; dhe në mendimin e tij, si edhe në atë të çifutëve, vullneti i Zotit ishte që gjendet në Ligjin dhe në librat tjerë të shkrimeve të shenja biblike." (35)

Çka thotë Bibla për Zotin dhe Jezusin a.s.

Pasazhet e mëposhtme nga Bibla projektojnë natyrën e vërtetë të Zotit dhe Jezusit a.s. Është e qartë tani se vetëm Zoti është Supremi, Sunduesi, i Lartësuari pa të meta dhe Transcedenti (përtej botës materiale). Jezusi a.s., një qenie e fundme, që vuan nga dëshirat e tij dhe i nënshtrohet vullnetit të Zotit. Të gjitha deklaratat dhe veprimet e tij qartësisht tregojnë nënshtrimin dhe varësinë e tij ndaj Zotit.

1. Dëshmia e Biblës për Zotin

Mësimet e Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re janë në thelb monoteistike dhe se Dhjata e Re nuk është etapë e një tranzicioni nga Një Zot në Tre-në-një-Zot (trinjësim të Zotit).

Jezusi e vërtetoi këtë në mësimet e tij duke thënë: "Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; unë nuk erdha për t'i shfuqizuar, po për t'i plotësuar. Sepse në të vërtetë ju them: Deri sa qelli dhe toka, të kalojnë asnjë jotë a asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojnë, para se të plotësohet gjithçka." (Mateu 5:17-18, Bibla)

Deklaratat e Zotit janë të thjeshta, të qarta dhe pa kundërshtime dhe konfuzione. Këtu janë disa nga "fjalët e frysmezuara" të Zotit në Bibël. Pra kështu, Zoti thotë:

"Unë jam Perëndia i plotfuqishëm." (Zanafilla 17:1, Bibla)

"Kush barazohet me ty midis perëndive, o Zot? Kush barazohet me ty, i mrekullueshëm në shenjtëri, i madhërishëm në lëvdata, o çudibërës?" (Eksodi 15:11, Bibla)

"Unë jam Zoti, Perëndia yt..." (Eksodi 20:2, Bibla)

"Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t'i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz..." (Eksodi 20:3-5, Bibla)

Këto citime kategorikisht ndalojnë çfarëdo lloji të imazheve që i përshkruhen Zotit, qoftë me anë të artit natyralist apo atij realistik. Nuk ka imazh që mund të jetë i përshtatshëm dhe adekuat për Zotin përvçëse Vetja e Tij. Pasi që Ai është Transcendent, Ai nuk mund të portretizohet nga ana e njeriut, përpos që t'i përshkruhet ajo që e shpalli Ai vetë si Atribute të Tij Hyjnore të përcjellura përmes profetëve.

"... Unë jam Zoti Perëndia juaj. Mos iu drejtoni idhujve dhe mos bëni perëndi me metal të shkrirë. Unë jam Zoti, Perëndia juaj." (Levitiku 19:3-4, Bibla)

"Perëndia nuk është një njeri, që mund të gënjejë, as edhe bir njeriu që mund të pendohet." (Numrat 23:19, Bibla)

"Të tëra këto të janë treguar, në mënyrë që të pranosh se Zoti është Perëndi dhe që nuk ka asnjë tjetër veç tij." (Ligji i Përtërirë 4:35, Bibla)

"Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm." (Ligji i Përtërirë 6:4, Bibla)

"Tani e shikoni që unë jam Ai dhe që nuk ka Perëndi tjetër përbri meje." (Ligji i Përtërirë 32:39, Bibla)

"Nuk ka asnjë të shenjtë si Zoti, sepse nuk ka asnjë tjetër vëç teje, nuk ka asnjë shkëmb si Perëndia ynë." (1 i Samuelit 2:2, Bibla)

"O Zot, Perëndia i Izraelit, nuk ka asnjë Perëndi të ngjashëm me ty as atje lart në qiell, as këtu poshtë në tokë!" (1 i Mbretërve 8:23, Bibla)

"Sepse ti je i madh dhe kryen mrekulli; vetëm ti je Perëndia." (Psalmet 86:10, Bibla)

"Nuk e di ti, vallë, nuk e ke dëgjuar? Perëndia i përjetësisë, Zoti, krijuesi i kufijve të tokës, nuk mundohet dhe nuk lodhet, zgjuarësia e tij është e panjohshme." (Isaia 40:28, Bibla)

"Unë jam Zoti, ky është emri im; nuk do t`i jap lavdinë time asnjë tjetri, as lavdërimet e mia shëmbëlltyrave të gdhendura." (Isaia 42:8, Bibla)

"Dëshmitarët e mi jeni ju, thotë Zoti, bashkë me shërbëtorin që kam zgjedhur, me qëllim që ju të më njihni dhe të keni besim tek unë, si dhe të merrni vesh që unë jam. Para meje asnjë Perëndi nuk u formua dhe pas meje

"nuk do të ketë asnë tjetër. Unë, unë jam Zoti dhe përveç meje nuk ka Shpëtimtar tjetër." (Isaia 43:10-11, Bibla)

"Unë jam i pari dhe jam i fundit, dhe përveç meje nuk ka Perëndi." (Isaia 44:6, Bibla)

"Unë jam Zoti dhe nuk ka asnë tjetër; jashtë meje nuk ka Perëndi ... me qëllim që nga lindja në perëndim të pranohet që nuk ka asnë Perëndi përveç meje. Unë jam Zoti dhe nuk ka asnë tjetër." (Isaia 45:5-6, Bibla)

"Sepse kështu thotë Zoti që ka krijuar qiejtë, ai, Perëndia që ka formuar tokën dhe e ka bërë; ai e ka vendosur, nuk e ka krijuar pa trajtë, por e ka formuar që të banohej: "Unë jam Zoti dhe nuk ka asnë tjetër." (Isaia 45:18, Bibla)

"Kujtoni gjërat e kaluara të kohëve shumë të vjetra, sepse unë jam Perëndia dhe nuk ka asnë tjetër; jam Perëndia dhe askush nuk më ngjet mua." (Isaia 46:9, Bibla)

"...Unë jam ai që është; unë jam i pari dhe jam i fundit gjithashtu. Dora ime ka themeluar tokën dhe dora ime e djathtë ka shpalosur qiejtë..." (Isaia 48:12, Bibla)

"Kështu thotë Zoti: "Qielli është froni im dhe toka është mbështetësja e këmbëve të mia." (Isaia 66:1, Bibla)

"Por Zoti është Perëndia i vërtetë, ai është Perëndia i gjallë dhe mbreti i përjetshëm...Kështu do t'u thoni atyre: "Perënditë që nuk kanë bërë qiejt dhe tokën do të zhduken nga toka dhe nën qiellin"." (Jeremja 10:10-11, Bibla)

"Unë jam Zoti, Perëndia yt." (Osea 13:4, Bibla)

2. Dëshmia e Biblës për Jezusin a.s

Lindja e Jezusit a.s. ishte e parashikuar: "Në muajin e gjashtë, engjëlli Gabriel u dërgua nga Perëndia në një qytet të Galilesë, që quhej Nazaret, te një e virgjër, që ishte e fejuar me një njeri që quhej Jozef, nga shtëpia e Davidit; dhe emri i virgjëreshës ishte Maria." (Luka 1:26-27, Bibla)

Ja pra, Zoti nuk ka zbritur për t'u bërë mish siç pretendohet nga kishat, por Ai dërgoi engjëllin e Tij Gabriel për ta informuar Marinë në lidhje me Planin e Zotit. Jezusi a.s. ishte një shpirt i krijuar në mitrën e Marisë me anë të fuqisë së Zotit. Andaj, prej këtu shfugizohet doktrina e Zotit të Mishëruar dhe në këtë mënyrë e bën pretendimin si të pabazë.

Engjëlli Gabriel e informon Marinë: "Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t`ia vesh emrin Jezus." (Luka 1:31, Bibla)

Pra, cilët ishin anëtarët e Trinitetit (d.m.th., Hyjnia Tre-në-Një) para lindjes së Jezusit a.s.? Në fillim nuk ka patur tjetër vetëmse Një Zot të vërtetë, i Cili jeton përgjithmonë. Triniteti është një ndryshim nga besimi në Një Zot (Monoteizëm) për në besimin në tre zota (politeizëm, paganizëm). Para Jezusi (Isait) a.s. njerëzit besonin vetëm në Një Zot, kurse pas lindjes së tij kishat I shtuan edhe dy persona në Hyjninë. Së dyti, Jezusi a.s. kur ishte embrion, a thua ka qenë i Plotfuqishmi Zot gjithashtu i fryshtuar? Që atëherë kur Trinitarët pretendojnë se dy apo tre persona qenë të bashkuar në një trup. A thua vallë të gjithë ata janë rritur si një embrion në mitrën e Marisë? Nëse është kështu, atëherë pse ajo e lindi vetëm Jezusin? Sa ide të papjekura foshnjarake dhe pështjelluese që mendojnë se Jezusi a.s. është bashkuar në një trup me Zotin?

Zoti, i Cili nuk ka fillim dhe nuk ka mbarim krijoj qiejt dhe tokën dhe çdo gjë që ekziston në mes tyre milionë vjet më parë, shumë më parë ardhjes së qytetërimit njerëzor. Shumë gjenerata kanë kaluar para lindjes së Jezusit a.s.

"Dhe kur kaluan të tetë ditët, pas të cilave ai duhej rrëthprerë, ia vunë emrin Jezus...". (Luka 2:21, Bibla) Çfarë blasfemie kundër Zotit! Nëse Jezusi a.s. është Zot i vërtetë, a beson se ai ka nevojë të jetë i rrëthprerë (i bërë synet)?

"Ndërkaq fëmija rritej dhe forcohej në frymë, duke qenë plot dituri; dhe hiri i Perëndisë ishte mbi të." (Luka 2:40, Bibla) Në fillim, ky "zot" Jezusi nuk ishte i pajisur me dituri kur ai ishte i vogël, por fitoi dituri dhe urtësi kur ai arriti moshën e adoleshencës. Urtësia e vërtetë e Zotit as që rritet e as që ulet, Ai as që i nënshtrohet kohës dhe hapësirës, sepse Ai gjithmonë është i Përsosur dhe Absolut.

Kur Jezusi a.s. lutej "Lutja e Zotit" (Luka 11:2-4, Bibla) A ka dikush që i lutet vetë shpirtit të vet? Sigurisht jo! Andaj kjo e dallon Zotin e vërtetë nga Profeti Jezusi (Isai) a.s. Përveç kësaj, vullneti i Jezusit është i ndarë nga vullneti i Zotit, e cila tregon se ata nuk janë një dhe nuk janë të barabartë njëri me tjetrin.

Përmendet se Profeti Jezus agjëroi: *"Dhe, mbasi agjëroi dyzet ditë e dyzet net, në fund e mori uria..."* (Mateu 4:2, Bibla) Agjërimi është një mënyrë për shlyerjen e mëkatit të dikujt dhe të treguarit bindje dhe servilizëm ndaj dikujt që është në pozitë më të lartë. Zoti nuk është as i nënshtruar dikujt e as që ka nevojë të agjërojë për shlyerjen e mëkateve të Tij, as edhe të vuajë nga ajo që dëshiron, por ndryshe nga Jezusi a.s. Zoti është i lirë nga çdo gjë, sepse vetëm Ai është më i Lartë dhe i Përsosur.

Një tubim i madh i njerëzve erdhën për të dëgjuar Jezusin a.s. dhe i sollën me veti shumë njerëz të sëmurë të cilët u shëruan nga gjyqtitë dhe sëmundjet e tyre. (Mateu 15:31, Bibla): *"...dhe lëvdonin Perëndinë e Izraelit."* Si mund të jetë Zoti i krishterëve Tre, ndërsa Zoti i Izraelit Një?

"Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej duke thënë: ``Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë; megjithatë, jo si dua unë, por si do ti``." (Mateu 26:39 dhe Marku 14:35-36, Bibla) Kujt i drejtohej Jezusi a.s. në lutjen e tij? A thua i drejtohej vetes duke qenë pjesë e Hyjnise? Definitivisht jo! Në fakt, Jezusi a.s. gjithmonë i lutej Zotit për ndihmë madje edhe kur e ktheu në jetë (e ringjalli) Llazarin. (Gjoni 11:41-43, Bibla) Jezusi a.s. ka qenë gjithmonë mirënlohës dhe falënderues ndaj Zotit që tregon pafuqinë e tij totale dhe servilizëm ndaj Zotit.

"Në mëngjes, kur po kthehej në qytet e mori uria. Dhe gjatë rrugës pa një fik dhe iu afrua, por nuk gjeti asgjë përveç gjetheve; dhe i tha: ``Mos u lidhtë më kurrë frys prej teje përjetë!``. Dhe fiku u tha menjëherë." (Mateu 21:18-19, Bibla) Zot që ndihet i uritur dhe në padijeni për sezonat kur drunjë mbajnë fruta!

Shën Pali thotë: "Burra të Izraelit, dëgjoni këto fjalë: Jezusi Nazareas, njeriu i dëftuar nga Perëndia ndër ju me vepra të fuqishme, me mrekulli dhe shenja që Perëndia bëri ndër ju me anë të ti tij..." (Veprat e Apostujve 2:22, Bibla) Këtu, është qartë se çfarë ka për qëllim Pali me fjalët "i dëftuar (i dëshmuar) nga Zoti (Perëndia)" që do të thotë se është "i vajosuri, i mirosur nga Zoti" apo " i zgjedhur nga Zoti – si profet".

3. Çka thotë Jezusi a.s. për Zotin dhe veten

Jezi Krishti a.s. nuk ka përmendur asnjëherë diçka në lidhje me Trinitetin e as që ishte në dijeni për të qenit tre persona hyjnor në Hyjni (Perëndi-Zot). Koncepti i tij ishte po ai i njëjti me atë të profetëve të mëhershëm izraelitë, të cilët predikuan besimin që thirrë në Njëshmërinë e Zotit.

"Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot, dhe: Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde,

me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!" (Mateu 12:29-30, Bibla)

"Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij." Kjo gjendet në Ungjittë e (Mateu 4:10) dhe (Luka 4:8) që të dyjet në Bibël: Jezusi a.s. thotë se vetëm Zoti është që duhet të adhurohet.

"Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot..." (Marku 12:29, Bibla) Jezusi a.s. konfirmon Njëshmërinë e Zotit.

"...por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiej." (Mateu 7:21, Bibla) Është e qartë se Zoti ishte në qiej kurse Jezusi a.s. në tokë, prandaj si mund që ata të janë të bashkuar në një trup?

Në kredon krishtere theksohet se 'Tre personat' janë të bashkuar në një trup (tre-në-një Zot). Si është e mundur për të gjithë anëtarët e Trinitetit që të janë Zot i plotë përderisa secili prej tyre përbën vetëm 1/3 e Hyjnisi?

"Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar." (Gjoni 17:3, Bibla) Këtu, Jezusi a.s. tërroqi një vijë në mes të Zotit dhe vetes së tij. Që të arrihet jeta e përjetshme duhet të njohet (pranohet) Zoti i vërtetë dhe se Jezusi a.s. u dërgua vetëm si një i dërguar i Zotit.

Jezusi a.s. thotë: *"Përse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë."* (Marku 10:18, Bibla) Jezusi a.s. pohon se askush nuk është i mirë përveç Zotit (Perëndisë), në këtë mënyrë bëri dallimin nëmes Zotit dhe vetes së tij.

"Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiel, as Biri, por vetëm Ati." (Mateu 24:36 dhe Marku 13:32, Bibla). Jezusi a.s. pranon se njohuritë e tij janë të kufizuara për dallim nga Zoti, i Cili është i

Gjithdijshëm. Gjithashtu, Gjykimi i takon vetëm Zotit, i Cili i mban të gjitha sekretet për Vete.

"Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes..." (Gjoni 5:19, Bibla)
Këtu, Jezusi a.s. e pranon varësinë e tij në Zotin.

"Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime; gjykoj sipas asaj që dëgjoj dhe gjyqi im është i drejtë, sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit që më ka dërguar." (Gjoni 5:30, Bibla)

"Sepse unë kam zbritur nga qielli jo për të bërë vullnetin tim, por vullnetin e atij që më ka dërguar." (Gjoni 6:38, Bibla)

"Doktrina ime nuk është imja, por e atij që më ka dërguar." (Gjoni 7:16, Bibla)

"...nuk bëj asgjë prej vetvetes, por i them këto gjëra ashtu si Ati më ka mësuar." (Gjoni 8:28, Bibla)

Jezusi a.s. e bën mjaft të qartë faktin se atij i mungon fuqia hyjnore. Me përpjekjet e veta nuk mund të bëjë asgjë meqenëse vetëm Zoti është burimi i vetëm i fuqisë (pushtetit) dhe kompetencës.

"Por ju tani kërkoni të më vrisni mua, që ju kam folur të vërtetën që kam dëgjuar nga Perëndia..." (Gjoni 8:40, Bibla) Jezusi a.s. pranoi se ai ishte vetëm një i Dërguar i cili është duke e përbushur misionin e tij me të cilin është urdhëruar nga Një, Më i Lartë.

Më tej, Profeti Jezus a.s. thotë: *"...Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj."* (Gjoni 20:17, Bibla) Ky verset i vë një fund Doktrinës së Trinitetit dhe Doktrinës së Mishërimit. Kjo tregon se lidhja e Jezusit a.s. me Zotin i ngjason lidhjes e kujtdo qenie tjetër

njerëzore me Zotin d.m.th. e adhuron, i lutet dhe kërkon ndihmë prej Tij.

Të gjithë versetet e mësipërme e tregojnë në mënyrë të përpiktë inferioritetin, dobësinë dhe varësinë e Jezusit a.s. në mirësinë e Zotit.

Çka thotë Kur'ani për Zotin

Kur'ani është Shpallja (Relevata) e fundit dhe përfundimtare e Allahut (Zotit) të Plotfuqishëm. Në shpalljen e Tij tregon përvjetorin e Tij të Lartësuar në mënyrën më të kulluar që nuk le hapësirë përfshirë çfarëdo interpretimi tjetër përveç të atij që përfshirë nga kuptimet e fjalëve të shkruara. Fjalët e Allahut të Plotfuqishëm dhe ato të profetëve të Tij janë fjalët e të së vërtetës. Nuk ka dyshim, fjalët e Tij janë të qarta, të thjeshta dhe vetëkuptueshme pa konfuzion. Allahu është Krijuesi, Shpikësi i Pashembullt i qiejve dhe tokës, Fuqia dhe Dituria e të Cilit është e pafund. Ai është Zoti, i Lartësuar dhe Furnizuesi përvjetor i gjitha krijesat. Andaj, njerëzit nuk duhet të mashtrohen nga iluzionet e rreme se mund të ekzistojnë zota të tjerë përpos Allahut (Zotit) Një, Sunduesit Suprem.

Le të reflektojmë në lidhje me atë çka thotë Kur'ani për Allahun (Zotin-Perëndinë), i Cili posedon Atributet e Përkryera që i përshtaten vetëm Hyjnisi së Vërtetë, Atij që është Transcendent:

"Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!"

Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve!

Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Sunduesit tē Ditēs sē Gjykimit (përgjegjësisë-shpërbllimit)!

Vetëm Ty tē adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë!

Udhëzona (përforcona) në rrugën e drejtë!

Në rrugën e atyre, tē cilët i begatove me tē mira, jo në tē atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në tē atyre që e humbën veten!" (El-Fatiha 1:1-5, Kur'ani)

"O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve edhe ata që ishin para jush ashtu që tē jeni tē devotshëm (tē shpëtuar).

Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me tē cilin ju siguroi lloje tē frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani All-llahut shokë, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shokë)." (El-Bekare 2:21-22, Kur'ani)

"Si e mohoni All-llahun, e dihet se ju ishit tē vdekur e Ai ju ngjalli, mandej ju bën tē vdisni e pastaj ju ringjall, e mandej tek Ai do tē ktheheni?

Ai (All-llahu) është që për ju krijoi gjithçka që ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej. Ai është i Gjithëdijshmi për çdo gjë." (El-Bekare 2:28-29, Kur'ani)

"Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli tē mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: "Bëhu!", në atë moment bëhet." (El-Bekare 2:117, Kur'ani)

"All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund tē ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di tē tashmen që është pranë tyre dhe tē

ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi." (El-Bekare 2:255, Kur'ani)

"...All-llahu është Ai që jep jetë dhe jep vdekje dhe All-llahu sheh atë që ju punoni." (Ali Imran 3:156, Kur'ani)

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoj palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju." (En-Nisa 4:1, Kur'ani)

"Thuaju: A adhuroni pos All-llahut atë që nuk mund t'ju sjellë as dëm e as dobi? All-llahu është që dëgjon (ç'thoni) që di (ç'veproni)." (El-Maide 5:76, Kur'ani)

"Thuaj: "A pos All-llahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër?"

Thuaj: "Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe (urdhërohem): të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët." (El-En'am 6:14, Kur'ani)

"A i përshkruajnë shok atë çka nuk mund të krijojë asnjë send, e ata (idhujt) vetë janë të krijuar.

Ata (idhujt) nuk mund t'u sjellin atyre ndonjë ndihmë e as veten e tyre ta ndihmojnë." (El-A'raf 7:191-192, Kur'ani)

"Ai është All-llahu, nuk ka zot pos Tij, Atij i takojnë emrat më të bukur." (Taha 20:8, Kur'ani)

"Ai që e fillon krijimin (e njeriut) e pastaj e përsërit atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka. A mos ka zot tjetër pos All-llahut? Thuaj: "Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të singertë!"

Thuaj: "Askush veç All-llahut as në qiejt, as në tokë nuk e di të fshehtën, as nuk e dinë se kur ringjallen!"" (En-Neml 27:64-65, Kur'an)

"Vetëm të All-llahut janë të gjitha që gjenden në qiej e në tokë; All-llahu është Ai që s'ka nevojë dhe është i lavdishëm." (Lukman 31:26, Kur'ani)

"(Ai mbetet) Atij i drejtohet me lutje kush është në qiej e në tokë dhe Ai në çdo moment është i angazhuar në çështje të reja (falë mëkate, largon brengosje, jep jetë, jep vdekje, krijon gjendje, zhduk të tjera etj.)." (Err-Rrahman 55:29, Kur'ani)

"Ai është All-llahu që nuk ka zot tjetër përveç Tij, sundues i përgjithshëm, i pastër (prej të metave që i mvishen), shpëtimtar (që i shpëton njerëzit prej ndëshkimit të padrejtë), sigurues (që i siguroi njerëzit me premtimin e vet dhe pejgamberët me mrekulli) mbikëqyrës (që mbikëqyr dhe përcjell çdo send), i plotfuqishëm, mbizotërues, i madhërishëm. I lartësuar është All-llahu nga çka i shoqërojnë!" (El-Hashr 59:23, Kur'ani)

"Ai është që u krijoi juve, e nga ju ka mohues dhe ka besimtarë. All-llahu e sheh shumë mirë atë që e punoni." (Et-Tegabun 64:2, Kur'ani)

"Thuaj: Ai, All-llahu është Një!

All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.

As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.

Dhe Atij askush nuk i është i barabartë." (El-Ihlas 112:1-4, Kur'ani)

Faktet biblike për doktrinën e Trinitetit

Trinitarët, në mbështetje të Trinitetit, citojnë vetëm disa versete nga Bibla, interpretimet e të cilëve janë shumë të çuditshme. Ata janë ose shumë larg nga konteksti ose nga teksti origjinal. Mësimet e Biblës në tërësi thirrin në Monoteizëm (Njëshmëria e Zotit), duke nisur nga libri i parë (Zanafilla) deri në librin e fundit (Zbulesa).

Në vijim janë disa nga versetet e cituara si argumente për vërtetësinë e doktrinës së Trinitetit:

Argumenti i parë që paraqitet është verseti që gjendet në (Letra e 1-rë, Gjoni 5:7, Bibla) në Versionin e King James (KJ) të Biblës, e autorizuar në vitin 1611: "Ata të cilët dëshmojnë në qiej janë tre: Ati, Fjala dhe Shpirti i Shenjtë, e këta të tre janë Një." Ky verset ka qenë i fshehur nga shumica e botimeve të korriguara të Biblës, pasi që u sajua se nuk ka qenë në dorëshkrimin origjinal, por është një shtesë e mëvonshme. (36)

Argumenti i dytë është në (Mateu 28:19, Bibla): "*Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë.*"

Argumenti i tretë është në (2 e Korintasve 13:12-13, Bibla): "*Të gjithë shenjtorët ju përshëndesin. Hiri i Zotit Jezu Krisht, dashuria e Perëndisë dhe bashkësia e Frymës së Shenjtë qofshin me ju të gjithë.*"

Argumenti i katërt është në (1 e Korintasve 12:4-6, Bibla): "*Ka larmi dhuntish, por i njëjti Frymë. Ka edhe larmi shërbimësh, por i njëjti Zot. Dhe ka larmi veprimtarish por është i njejti Perëndi i cili i bën të gjitha gjërat në të gjithë.*"

Përsa i përket argumentit të dytë, tretë dhe katërt, thjeshtë vetëm përmendja e emrave (emërtimet) asesi nuk e

themelon apo nuk e formon Trinitetit, si edhe numërimi e tyre. Ata, në fakt, janë tre qenie të ndara me shtatlartësi dhe rrethana të ndryshueshme. Të tre nuk kanë qenë kurrë të barabartë në kohë, pozitë, dituri, fuqi (pushtet) siç është e definuar në doktrinën e Trinitetit. Përveç kësaj, kur u pagëzua Jezusi në bazë të (Mateu 3:16, Bibla), Shpirti i Zotit zbriti në të në formën e një pëllumbit. Pasi është kështu, si mund që Jezusi a.s. të pretendohej të jetë si pjesë e Trinitetit, kur ai ishte gjithmonë me Shpirtin (Frymën) e Shenjtë?

Disa nga versetet në Bibël janë dhënë si dëshmi për ngritjen e Jezu Krishtit a.s. në pozitën e Zotit (Hyjnisë) në bazë të formimit të mëvonshëm të doktrinës së Trinitetit:

Shembulli i parë: "*Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë...*" (Zanafilla 1:26, Bibla). Disa teologë të krishterë kanë ardhur në përfundim se Zoti nuk ka qenë një dhe i vetëm në kohën e krijimit. Megjithatë, Zoti flet për veten e Tij në shumës veta e parë dhe kjo mund të shpjegohet si një shumës intensive nga i cili nënkuptohej madhështia, lartmadhëria dhe lavdia e Zotit. Dijetarët krishterë e shpjegojnë këtë se është duke simbolizuar plotësinë e fuqisë hyjnore apo pushtetin e pakufishëm të manifestuar në Zotin apo dijeninë e pafund të Zotit në tërësi. Disa e quajnë atë shumësi i respektit, nderimit dhe në gramatikë është referohet të jetë si shumës i madhërisë. Në librin 'Zanafilla', libri i parë i Biblës, Zoti i vetëm, pa asnje ndihmës ka bërë Krijimin (p.sh. kapitulli 1, verseti 3, Bibla): "*Pastaj Perëndia tha: "U bëftë drita!". Dhe drita u bë.*" Në versetin 27 të kapitullit të njëjtë thotë: "*Kështu Perëndia krijoi njeriun simbas shëmbëlltyrës së vet.*" Versetet e mësipërme nuk tregohet të ketë patur Zoti çfarëdo qoftë ndihmëtari apo shoqëruesi. Dhe folja e cila përshkruan atë se çka ka thënë Zoti dhe çka ka bërë është në njëjës (p.sh. Zoti pa që drita ishte e mirë, Zoti krijoi kupën qellore, Zoti krijoi njeruin, Zoti i bekoi ata, Zoti e mbaroi punën e Tij, etj.)

Në fillim të librit 'Zanafilla' lexojmë: "Në fillim Perëndia krioi qiejt dhe tokë." Vini re se fjala 'qiejt' është në shumës ndërsa fjalët 'Zot (Perëndi)' dhe 'tokë' janë në njëjës. Pse fjala 'qiej' është në shumës? Arsyja është e thjeshtë; Kur'ani na tregon neve se qelli është i përbërë nga shtatë shtresa qellore. E përse shkrueshit e Biblës i ruajnë fjalët 'Zot-Perëndi' dhe 'tokë' në formën e njëjës? Kjo ishte për shkak se ata e dinë me siguri se toka është vetëm një dhe Zoti është vetëm një siç është predikuar dhe mësuar nga të gjithë profetët e Zotit.

Shembulli i dytë: "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi." (Gjoni 1:1, Bibla) Vini re se ai që fliste nuk ishte Jezusi a.s., por ishte Gjoni. Përveç kësaj, çdo dijetar krisher biblist e pranon faktin se këtë verset të veçantë e ka shprehur një hebre, i quajtur Filo i Aleksandrisë në Egjipt, përpara ardhjes së Jezusit dhe Gjon Pagëzorit, paqa qoftë mbi ta.

Më tej, shumë përkthyes të dorëshrimeve greke në gjuhën angleze në (Gjoni 1:1, Bibla) në rastin e parë shkronjën e parë të fjalës (God-Perëndi) e kanë shkruajtur me shkronjë të madhe, e cila i referohet Zotit të Plotfuqishëm, por në rastin e dytë e kanë e kanë shkruajtur me shkronjë të vogël (god-perëndi). Shkronja e vogël zakonisht përdoret për kriesat e jo për Zotin e Plotfuqishëm, siç është në (Psalme 82:6, Bibla): "Unë kam thënë: "Ju jeni perëndi, jeni të gjithë bijtë e Shumë të Lartit." Dhe në (2 e Korintasve 4:4, Bibla): "Të cilëve perëndia i këtij shekulli ua verboi mendjet e atyre që nuk besojnë..." Meqenëse kjo fjalë (në rastin e dytë) është vetëm 'perëndi', atëherë nuk mund të jetë fjala për Zotin (Perëndinë) e Plotfuqishëm por është vetëm një 'zot-perëndi' siç shihet në shembujt e mësipërm.

Andaj, përkthyesit modern të Biblës japid kuptimin e (Gjoni 1:1, Bibla) në shembujt e mëposhtëm:

"Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë (with God), dhe Fjala ishte perëndi." (37)

"Në fillim Fjala ishte (the Word was) dhe Fjala ishte me Perëndinë, dhe Fjala ishte perëndi." (38)

Në anën tjetër, disa dijetarë krishterë e kanë përkthyer termin "Fjala" si "Urdhëri Hyjnor", kështu që ata pretendojnë se frazeologjia e saktë në (Gjoni 1:1-3, Bibla) duhet patjetër të jetë: " Në fillim ishte Urdhëri dhe Urdhëri ishte me Perëndinë, dhe Urdhëri ishte Hyjnor. Ai (Urdhëri) ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij (Urdhërit), dhe pa atë nuk u bë asnje nga ato që u bënë." Në termin grek që është përdorur nga Gjoni është '**Logos**', rrjedh nga fjala `lego` – që ka kuptimin 'të folurit'. Termi në anglisht 'Decalogue' e ka kuptimin 'Dhjetë Urdhërat (Porositë)' dhe është ndërthurje e dy fjalëve greke '**deka**' (Dhjetë) dhe '**logous**' (Urdhëra-porosi). Termi 'Logos' që do të thotë "Urdhëri (porosia) e folur e Zotit (Perëndisë)". (39)

Fjala 'me' apo 'pranë' krijon një dilemë enigmatike për ata të cilët preferojnë që fjala 'Logos' t'ia japid kuptimin të jetë 'Jezusi' në vend të 'Urdhërit (porosisë)'. Arsyja është shumë e qartë: *Si mund të jetë Jezusi me Zotin (Perëndinë) dhe njëkohësisht të jetë ai Zoti (Perëndia)?*

Koncepti i të qenit 'Urdhëri i folur i Perëndisë' 'me Perëndinë' që nga 'fillimi', përputhet me konceptin biblik për Krijimin. "Pastaj Perëndia tha: "U bëftë drita!". Dhe drita u bë." (Zanafilla 1:3, Bibla). Në tekstin grek, Gjoni ka përdorur nyjen shquese 'the – **ho**' përpara 'God – **Theo**' (në shq. Perëndia), sepse është Kryefjalë. Këtu, Gjoni nuk ka përdorur nyjen shquese 'the' përpara 'God' (në shq. Perëndi) sepse është Kallëzues. Me fjalë tjera, termi i përdorur këtu simbolizon në natyrën, cilësinë, karakteristikën apo pronësinë e vetë Kryefjalës (vepruesit). Në këtë rast, natyra e Urdhërit të Perëndisë është Hyjnore. Në disa versione biblike, fjala 'This – Ky' është zëvendësuar me 'This (one) – Këtë' ose 'He (Jesus) – Ai (Jezusi)'. Megjithatë, fjala 'This – Ky' i referohet 'Urdhërit të folur të Perëndisë'.

Për më tepër, është e qartë se në (Gjoni 1:1, Bibla) thuhet se ishte vetëm Zoti Ai i Cili ka ekzistuar që nga përjetësia (pafundësia). Fjalët e Tij janë gjithmonë me Të, në të njëjtën frysë sikur që janë fjalët tuaja me ty dhe fjalët e mia me mua. Fjalën të cilën e nxjerr Zoti nuk është tjetër Zot (Perëndi) apo Vetë Perëndia por një Fjalë Hyjnore (Urdhër-Porosi) nga Ai. Përndryshe, çdo krijesë do të bëhet një Perëndi i veçuar përderisa çdo krijesë përfaqëson Fjalën e Tij. I njëjti argument përshtatet me (Zanafilla 1:3, Bibla). Drita e cila është e krijuar nga fjala e Tij nuk është Perëndi, por është një krijesë (dritë) nga Fjala e Tij Hyjnore. Prandaj, shprehja "Fjala ishte Perëndi" në Gjoni 1:1 në Bibël është absolutisht nuk është aspak me vend.

Përveç kësaj, në qoftë se përpigemi që të lexojmë shkrime të shenjta të tjera lidhur me Krijimin, ne do të kuptojmë se Zoti (Perëndia), Krijuesi ka përdorur Fjalët e Tij në çdo krijim të një krije, që ngjajshëm është e shprehur në Kur'an (p.sh. – "**Kun fejekuun**" që do të thotë në shqip "*Bëhu dhe ai menjëherë bëhet*") (40)

Shembulli i tretë: "*Unë dhe Ati jemi një.*" (Gjoni 10:30, Bibla). Të krishterët e kuptuan këtë verset që do të thotë se Ati (Zoti) dhe Jezusi a.s. janë një dhe qenie e njëjtë; të bashkuar në Një Trup; Zoti u bë nga mishi në pamjen e personit të Jezusit a.s. dhe jetoi në mesin e njerëzve. Kuptimi i njëjtë është dhënë në (Gjoni 14:10, Bibla) kur Jezusi (Isai) a.s. thotë: "*Unë jam në Atin dhe se Ati është në mua.*" Gjithashtu edhe në (Gjon 14:20, Bibla) kur thotë: "*Unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju.*" Megjithatë, ata e keqinterpretuan kuptimin në versetin 28 të të njëjtë kapitulli kur Jezusi a.s. deklaron: "Po të më donit, do të gëzoheshit sepse unë thashë: "*Po shkoj tek Ati*"; sepse Ati është më i madh se unë." Nëse ishte ajo që e kathënë Jezusi a.s. e vërtetë se Ati është më i madh se ai, atëherë merr fund kjo çështje dhe përfundohet se ata nuk janë të barabartë.

Gjithashtu, trinitarët nuk e dijnë se duke ndjekur argumentet e tyre, si rezultat del që formohet një shumë prej 15 trupave të mbështjellë në një trup. Kjo është një "aritmetikë e thjeshtë" që e llogarit një fëmijë në klasë të parë. Ati është Perëndi, Biri (Jezusi) është Perëndi dhe Shpirti i Shenjtë është Perëndi – (p.sh. Triniteti) përbëhet nga tre (3) qënieve (Personave) të cilët bashkohen në një Zot. Shtoni në të edhe dy mbëdhjetë (12) dishepujt në të njëjtën mënyrë siç e kuptojnë të krishterët (Gjoni 14:20), do të fitohet një shumë prej pesëmbëdhjetë (15) qënieve të mbështjellë dhe të bashkuar në një trup.

Versetet në (Gjoni 17:21-23, Bibla) do të na japid kuptim më të qartë për natyrën e të qënit një: "Që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar. Dhe unë u kam dhënë lavdinë që më ke dhënë, që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një. Unë jam në ta dhe ti në mua, që të jenë të përsosur në unitet..." Versetet e mësipërme nuk sugjerojnë asnjë kuptim tjetër përveçse "bashkimin e qëllimit" të tyre si besimtarë të vërtetë.

Përveç kësaj, në (Gjoni 10:31-36), Bibla) ai nuk pretendon të jetë "Perëndi" ose "Zoti Biri" (siç konsiderohen të bashkuar me Atin (Perëndinë)), por vetëmse që është një genie e ndarë.

Nëse, nga ana tjetër, Trinitarët insistojnë se (Gjoni 10:30, Bibla) mbështet doktrinën e Trinitetit, atëherë ata nuk duhet të kufizojnë numrin e Perëndisë së tyre vetëm me tre (3), por duhet t'i shtojnë edhe 12 dishepujt në (Gjoni 14:10 dhe 20, në Biblë) ashtu siç e kuptuan domethënien e tyre, duke qenë "secili i zhytur (i futur) në një trup." Prandaj, dilemma do të jetë më e madhe dhe lëmshi i ngatërruar (Triniteti) do të bëhet më problematik.

Shembulli i katërt: "Kush më ka parë mua, ka parë Atin..." (Gjoni 14:9, Bibla). Por Jezusi a.s. nuk ka thënë në mënyrë të qartë se "njerëzit nuk e kanë parë Zotin", siç thotë ai në

(Gjoni 5:37, Bibla)?: "Dhe Ati, që më dërgoi, ai vetë ka dëshmuar për mua; ju nuk e keni dëgjuar kurrë zërin e tij dhe as nuk e keni parë fytyrën e tij." Këtu, Jezusi a.s. thotë se ai nuk është Zot, sepse ai ishte duke folur me ta dhe ishin duke e parë atë. Dhe në (Mateu 7:21, Bibla), Jezusi a.s. thotë: "...*Atit tim që është në qiej.*" E kjo ndodhi përderisa ai ishte përpara tyre. Të gjitha këto deklarata të Jezusit a.s. kanë një kuptim të vetëm, pra, Zoti dhe Jezusi nuk janë të njëjtë. Si mund që Ati (Zoti) dhe Jezusi të jenë të njëjtë dhe të bashkuar në trup (siç interpretohet nga të krishterët), kur Ati është në qeill kurse Jezusi a.s. është mbi tokë?

Që të besosh në Zot, duhet të meditosh në krijesat e Tij të cilat janë të panumërtë: dielli, hëna, yjet, dhe çdo gjë rreth nesh. Në (Gjoni 4:24, Bibla), Jezusi a.s. pohon: "*Perëndia është Frymë*". Pra, si mund dikush që ta shohë Zotin? Dhe në (Gjoni 1:18, Bibla) lexojmë: "*Askush s'e pa Perëndinë kurrë.*"

Përveç kësaj, Jezusi a.s. solli një dallim të qartë midis Zotit dhe vetes në versetet e mëposhtme në (Gjonit 14:1, Bibla): "*Zemra juaj mos u trondittë; besoni në Perëndi dhe besoni edhe në mua!*" Fjala "edhe" është fjalë kyçë në fjali, që tregon se Qenia e Zotit është krejtësisht e ndarë nga ajo e Jezusit a.s. Në (Gjoni 17:3, Bibla): "*Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar.*"

Shembulli i pestë: (Gjoni 20:28, Bibla): "*Zoti im dhe Perëndia im!*" Megjithatë, ky pasazh nuk ka asnjëfarë rëndësie ngaqë bie poshtë sipas verseteve të cituara më sipër. Dijetarët janë të mendimit se nën rrethana të tillë të çudibërëse, vërejtjet e apostull Thomait mund të kenë qenë si një thirrje e tronditur për shkak të mahnitjes që pati ndaj Jezusit a.s., ndërsa në realitet, thirrja ishte e drejtar Jezuit. Përveç kësaj, Thomai e ka konsideruar Jezusin a.s. si Zot,

sepse ai dinte shumë mirë se Jezusi a.s. kurrë nuk ka pretenduar të jetë Zot. (Gjoni 17:3, Bibla).

Në fakt, Shën Pali jep një dallim tjetër të qartë midis Zotit dhe Jezusit a.s. Ai pohoi se Zoti e ka ringjallur Jezusin siç transmetohet në Bibël në dy vende (1 e Korintasve 15:15-20) dhe (Marku 16:19): "*Zoti Jezus, pra, mbasi u foli, u ngrit në qiell dhe u ul në të djathtë të Perëndisë.*" Nëse me të vërtetë, Zoti dhe Jezusi janë një dhe qenie e njëjtë, a nuk do të ishte më e përshtatshme të thuhej: "Jezusi e ngriti veten e tij lart?" dhe kur Jezusi a.s. transmeton të jetë ulur në të djathtën e Zotit (Perëndisë), a nuk do të ishte më e qëlluar të thuhet: "dhe Jezusi u ul në `Fronin`"? E vërteta e pamohueshme është – askujt nuk i jepet e drejta në Fronin e Lartësuar me përjashtim të Zotit, i Cili është i denjë dhe meritor për adhurim siç pohon edhe vetë Jezusi a.s. (Gjoni 17:30), Bibla).

Në një verset tjetër Shën Pali shpjegon se kush është Zoti (Veprat e Apostujve 17:24-25, Bibla): "*Perëndia që bëri botën dhe të gjitha gjërat që janë në të, duke qenë Zot i qiellit dhe i tokës, nuk banon në tempuj të bërë nga duart e njeriut, dhe as shërbehet nga duart e njerëzve, sikur të kishte nevojë për ndonjë gjë, sepse ai u jep të gjithëve jetë, hukatje dhe çdo gjë.*"

A është rëndë për ta perceptuar njeriu dallimin midis Zotit dhe njeriut, Krijuesit dhe krijesës, të Pakufizuarit (Zotit) dhe të kufizuarit (krijesës)? Me siguri që jo, por vetëm se naivët, hipokritët dhe të pashtuarit nuk do të kishin dashur që të kuptojnë.

Pretendime shtesë për ngritjes e Jezusit në Hyjni

Pretendimi i krishterëve është se Jezusi a.s. është Zoti i Mishëruar, duke qenë Zot i plotë dhe njeri i plotë. Ky koncept është totalisht i mohuar nga Jezusi a.s. me thëniet e tij në (Gjoni 20:17, Bibla): "*Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj.*" Pra, kur lindi

çështja e Mishërimit? Me fjalë të thjeshtë është treguar se Zoti i ndryshëm dhe i veçantë nga Jezusi a.s. Andaj kjo e bën doktrinën e Mishërimit të pavlefshme dhe sikur të mos ketë ekzistuar. Përveç kësaj, për të qenë Zot i plotë do të thotë të jeshë i lirë nga dëshirat, nevojat dhe paaftësisë, kurse për të qenë njeri do të thotë të jeshë i lirë nga çdo cilësi që i takon hyjnisë.

Krishterë të tjerë pohojnë se Jezusi a.s. është Zot sepse ai është i quajtur edhe "Birë i Zotit", "Mesia", "Birë i Njeriut" dhe "Shpëtimtar". Megjithatë, Jezusi kur ka folur për "ndërtuesit e paqes" i ka emëruar si "bijtë e Perëndisë (Zotit)". Në traditën çifute, çdo person i cili ndjek vullnetin e Zotit, është quajtur "Biri i Perëndisë (Zotit)". Shih shembujt e cituar në Bibël: (Zanafilla 6:2,4); (Eksodi 4:22); (Jeremja 31:9); (Psalmet 2:7); (Luka 3:38); (Romakëve 8:14). Në (Gjoni 6:35 – Bibla e King James), Jezusi a.s. thotë: "*Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bënu mirë atyre, jepni hua duke mos pritur nga ta shpërblim; e shpërblimi juaj do të jetë i madh dhe ju do të jeni bijtë e të Lartëmadhërishmit.*" Të qenët Biri i Perëndisë (Zotit), nuk e ngre atë në shkallën e Perëndisë. Ashtu si puna e të birit të një presidenti, nuk e bën president atë, por ai mbetet vetëm biri i presidentit.

Më tej, citohet në Bibël se "Mesia" në hebraisht do të thotë "i vajosuri, i mirosur nga Zoti" e jo "Krisht", kurse me fjalën persiane "Cyrus" është quajtur "Mesia" ose "i vajosuri, i mirosur". (Zanafilla 31:13); (Levitiku 8:10); (1 i Samuelit 2:10); (Isaia 45:1); (Ezekieli 28:14). Ezekieli emërohet në Bibël si "Biri i Njeriut". Kurse për emrin "Shpëtimtarë" që është në (2 i Mbretërve 13:5), gjithashtu u është dhënë ky titull disa individëve të tjerë duke mos qenë zota. Termi "i vajosuri i Zotit" do të thotë të dhënurit autoritet shpirtëror një njeriu fisnik për të përhapur fjalën e Perëndisë (Zotit). Pra, si mund që ky term t'i përshtatet dhe ta ngre atë në pozitën e Zotit?

Pyetje tjetër që kushton me miljardë dollarë: "Çfarë është krishterimi pa Doktrinën e Trinitetit?"

Argumente shtesë për hedhjen poshtë të dotrinës së Trinitetit

As edhe një herë nuk i referohen Jezusit a.s. me "Zoti Birë" por vetëm me "Biri i Zotit" ose "Biri i Perëndisë" rreth 68 herë në Dhjatën e Re të Biblës, që donte të thoshte se ai nuk është asesi Zot (Perëndi). Për të thënë se të dy referencat janë një dhe të njëjta në kuptim, atëherë anulon rregullat e gjuhës duke i konsideruar ato krejtësisht të kota dhe të padobishme si një mjet për komunikim. (41)

Jezusi e kishte fillimin e tij sepse ai ishte krijesë e Perëndisë (Zotit). Ai nuk ishte në përjetësi të përbashkët me Zotin, apo në përjetësinë e përbashkët të Zotit të Plotfuqishëm në asnjëfarë domethënie; ai ka qenë gjithmonë i nënshtuar vullnetit të Zotit dhe akoma mbetet që të jetë ashtu.

Ariusi e definon Zotin si 'agenetos' – që është *burimi final i çdo gjëje i Cili Vetë (Zoti) nuk është i nxjerrë nga asnjë burim. Kjo është ajo që e dallon Zotin në qenien e tij thelbësore nga të gjitha qeniet tjera. Logosi (ose Fjala) nga Ungjilli i Gjonit e përfton ekzistimin e saj nga Zoti, andaj pra ai nuk ka qenë absolutisht Zot.* (42)

Doktrina e Trinitetit është një devijim i qartë nga mësimet origjinale të profetëve të Zotit. Për ta adhuruar Zotin sipas vullnetit të Tij do të thotë të hedhësh poshtë doktrinën e Trinitetit në mënyrë masive. "Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por paqtimi." (1 e Korintasve 14:33, Bibla)

Kështu John Baker shkruan se 'Jezusi nuk e ka parë veten ndryshe vetëm si një njeri i zakonshëm, e jo si Shpëtimar i

botës, aq më pak si një qenie hyjnore para-ekzistente e zbritur nga qielli.' Ai pranon se Jezusi 'gaboi në lidhje me programin që ia planifikoi Zoti që ta ndjekë' dhe vazhdon të argumentojë se 'të jetë në gabim në lidhje me detajet e së ardhmes' është 'një tipar prej tipareve të natyrës njerëzore' që 'mund të tejkalohet vetëm duke e veshur (kurorëzuar) Jezusin me fuqitë mbinjerëzore që mund vërtet t'i plotësonteëndërrat e vjetra të paganizmit të lodhshëm dhe të mërzitshëm, por përjashton krejtësisht çfarëdo pretendimi përmishërimin e Zotit'. (43)

Duke e kuptuar këtë shumë të vërtetë, John Hick, redaktori i librit "The Myth of God Incarnate" ("Miti i Zotit të Mishëruar"), në parathënien e tij ka thënë:

"Nevoja (përmisë njohjen e të vërtetës) vjen nga rritja e njohurive të origjinës krishtere, që përfundon në njohjen dhe pranimin se "Jezusi ishte ashtu siç është paraqitur në (Veprat e Apostujve 2:22, Bibla) 'njeriu i dëftuar nga Perëndia' përmisë një rol të veçantë Brenda qëllimit hyjnor dhe se ideja e mëvonshme që konsiderohet si Zot i Mishëruar, Personi i Dytë i Trinitetit të Shenjtë, duke jetuar një jetë njerëzore, është një mënyrë mitologjike ose poetike e të shprehurit të rëndësisë dhe peshës së tij përmisë." (44)

Kredoja krishtere thekson se 'Tre Personat' janë të bashkuar në një trup (tre në një Zot). Si mund që ndonjëri prej anëtarëve të Trinitetit të konsiderohet Perëndi e plotë kur në të vërtetë secili prej tyre përbën vetëm 1/3 e Hyjnise? Është absurde madje edhe të mendojsh se secili prej tyre është një Perëndi e plotë kur njihet se të tre janë të mbështjellë në një qenie dhe në këtë mënyrë formojnë një Perëndi (Zot) të plotë.

Përsëri, kur ishte Jezusi a.s. në tokë, ai nuk ishte Zot i plotë, as që ishte "Ati në Qiell" një Zot i plotë, gjë që është në mospajtim me thëniet e Jezusit a.s. Ai thotë në (Gjoni 20:17, Bibla): "*Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te*

Perëndia im dhe Perëndia juaj." Po të ishte Perëndia tre-në-një, kush ishte Perëndia në Qiell gjatë tre ditëve midis kryqëzimit të pretenduar dhe ringjalljes? Kush ishte Perëndia gjatë kohës kur Jezusi ishte në barkun e Marisë?

Po të kishte qenë kjo doktrinë nga mësimi i Jezusit a.s., ai do të kishte dekluar me fjalë të qarta. Ndërkaq, fjalë Trinitet nuk është madje edhe e shkruar në Bibël, por në vend të kësaj, Jezusi thotë në (Marku 12:29, Bibla): "Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot..."

Shumë të krishterë kurrë nuk kanë menduar më ngatërresat që mund të sjelle koncepti i doktrinës tre-në-një Zot (Trinitetin). Si mundet që ta kënaqësh apo ta adhurojsh Zotin, përderisa në është i qartë fakti se kush është Perëndia (Zoti)?

"Filozofia na tregon se nuk ka mundësi që asnjë qenie e dalur nga një qenie tjetër dhe ekziston si një individ i veçantë, të bëhet i barabartë ose ortak dhe të mund të konsiderohet si i përsosur. Të përshkruarit Zotit që ka një bir paraqet të mohuarit e përsosmërisë së Zotit." (45)

"Ngritja e Jezusit a.s. në pozitën e lartë të Zotit arrin një blasfemi të tmerrshme kundër të vetmit një Perëndi të vërtetë, ndërkokë që ndarja e Jezusit nga Hyjnia nuk e zhvlerëson Jezusin, por vetëmse e vë atë në pozitën e tij më fisnike si një profet i madh dhe i dërguar i Zotit."

"Ai është që u krijoi juve, e nga ju ka mohues dhe ka besimtarë. All-llahu e sheh shumë mirë atë që e punoni." (46)

Më shumë dëshmi që refuzojnë pretendimin e doktrinës së Trinitetit:

"Ju me të vërtetë do ta pini kupën time dhe do të pagëzoheni me pagëzimin me të cilin unë do të

pagëzohem; por nuk është në dorën time që të uleni në të djathën time ose në të majtën time, por u është rezervuar atyre, të cilëve u është përgatitur nga Ati im." (Mateu 20:23, Bibla). Sa i takon vetes së tij, Jezusit i mungon pushteti apo autoriteti për të dhënë diçka përveç atë çka i caktohet nga Zoti, të Cilin ai e quan "Ati".

"Dhe, si shkoi pak përpara, ra me fytyrë për tokë dhe lutej duke thënë: ``Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë; megjithatë, jo si dua unë, por si do ti``." (Mateu 26:39, Bibla). Këtu Jezusi a.s. kërkon ndihmën e Atit të tij (Zotit), duke theksuar se kjo nuk do të jetë përmes vullnetit të tij, por me Vullnetin e Zotit. Duket qartë nga kjo se vullneti i tij është i veçuar nga ai i Zotit.

"Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?" (Mateu 27:46, Bibla) "...O Atë, në duart e tua po e dorëzoj fryshtë tim..." (Luka 23:46, Bibla) Fjalë të tilla, pra siç është 'Perëndia im' - 'O Atë' vijnë vetëm nga dikush që është në vështirësi. E nëse Jezusi a.s. ishte Perëndi, atëherë nga kush ishte ai i braktisur? Vallë mos ishte nga Vetvetja? Kjo është qesharake. Perëndia nuk ka nevojë që ta nënshtrojë Veten në ndonjë Perëndi tjetër.

"Përse më quan i mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë." (Marku 10:18, Bibla) Jezusi a.s. theksoi se asnjë nuk është më i madh në mirësi apo drejtësi përveç Perëndisë. Kështu që, e distancoi veten e tij nga Hyjnia.

"Sa për atë ditë dhe atë orë, askush nuk e di, as engjëjt në qiel, as Biri, por vetëm Ati." (Marku 13:32, Bibla) – Sikur të kishte qenë Jezusi a.s. me të vërtetë i barabartë me Perëndinë (Zotin) ose pjesë e Trinitetit, ai do të kishte ditur çfarëdo që dinte Ati.

"Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes..." (Gjoni 5:19, Bibla)

"Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime..." (Gjoni 5:30, Bibla)

"Doktrina ime nuk është imja, por e atij që më ka dërguar." (Gjoni 7:16, Bibla)

Në tre deklaratat e cituara më sipër, Jezusi a.s. bëri të qartë se nuk ka të drejtë apo pushtet që i mbetet atij dhe se atë që e predikonte ishte nga Perëndia.

"...Ati është më i madh se unë." (Gjoni 14:28, Bibla) – Kjo deklaratë kategorikisht e mohon doktrinën e Trinitetit pasi që të dy janë të natyrave të ndryshme, njëri më i madh se tjetri.

"Dhe kjo ështëjeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar." (Gjoni 17:3, Bibla) Perëndia kurrë nuk është përmendur në shumës nga Jezusi a.s., të Cilit ai i drejtohet si `Ati`.

"Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj." (Gjoni 20:17, Bibla) Jezusi a.s. nuk ishte Perëndi sepse ai kishte Perëndinë e tij të cilin ai e quajti atë `Ati`.

"Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin..." (Gjoni 3:16, Bibla) Nëse Jezusi a.s. është pjesë e Tinitetit dhe që të tre janë në përjetësi të përbashkët, pa fillim dhe pa mbarim, të barabartë në pozitë, si mund ai që të jetë një djalë (Biri) dhe në të njëjtën kohë të jetë aq i vjetër sa babai i tij (Ati)? (shih Mateu 1:18; Luka 1:26 dhe 1 e Gjonit 4:9, të gjitha në Bibël)

"Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri." (1 e Timoteut 2:5, Bibla) Deklarata është e vetëkuptueshme se Perëndia dhe Jezusi a.s. janë të ndryshëm nga njëri-tjetri.

"Zbulesa e Jezu Krishtit, që Perëndia ia dha për t'u treguar shërbëtorëve të tij gjërat që duhet të ndodhin për së shpejti." (Zbulesa 1:1, Bibla) Zoti i vërtetë është i Gjithëdijshëm, andaj kjo e hedh poshtë teorinë e Trinitetit.

A e miratoi Jezusi a.s. konceptin e Shpirtit të Shenjtë

Zoti me urtësinë dhe mëshirën e Tij të pafund, kohë pas kohe ka dërguar profetë për të përcjellë mesazhin e Tij dhe për ta ftuar njerëzimin në drejtësi (d.m.th., në rrugën e paqes dhe bindjes ndaj të Vetmin Një Zotit të Vërtetë.) Mesazhi quhet ISLAM (nënshtrim ndaj Vullnetit të Zotit).

Ky mesazh iu përcoll të gjitha kombeve dhe fiseve në botë për brezat e ardhshëm duke e ftuar njerëzimin që t'i nënshtrohen Vullnetit të Zotit. Megjithatë, të gjitha shpalljet e mëparshme u shtrembëruan dhe u korruptuan nga gjeneratat e mëvonshme dhe profetët ishin të injoruar dhe të persekuar. Shpallja e pastër e Zotit ishte e njollosur me mite, bestytni, adhurime idhujsh dhe ideologji joracionale (të paarsyeshme). Kështu që, feja e Zotit pati humbur në mesin e rrymave të shumta të adhurimeve të kota.

Historia njerëzore është një kronikë e tendencës së njeriut midis dritës dhe errësirës. Zoti, nga dashuria dhe mëshira e Tij e tepërt për njerëzimin nuk na ka lënë të jetojmë në errësirë duke kërkuar që të zbulojmë rrugën e drejtë vetëm duke u mbështetur në prova dhe gabime. Ai e dërgoi të Dërguarin e Tij të fundit, profetin **Muhamed** s.a.v.s. për ta udhëzuar njerëzimin gjatë kohës së ashtuquajtur 'Vitet e Errëta' ('Epoka e Mesjetës'). Shpallja hyjnore (p.sh., Kur'ani i Shenjtë, nëpërmjet të engjullit Xhibril-Gabriel) paraqet burimin e fundit të udhëzimit hyjnor i cili për nga natyra e tij është i kuptueshëm, gjithëpërfshirës dhe universal. Ky **Udhëzim Hyjnor** përshkruan njojurinë dhe

realitetin rreth Krijuesit të Gjithëfuqishëm, universit, qëllimit të krijimit tonë dhe të jëtës sonë në këtë botë dhe në botën tjetër. Kjo do të shpiejë njerëzimin në **rrugën e së vërtetës, drejtësisë** dhe **suksesit** në këtë jetë dhe në tjetrën.

Plotësisht është e saktë që të *thuash* për *ardhje* të "një tjetër protektori / avokati / ngushëlluesi / këshilltari / shpirti" të vërtetë sikur të *thuash* për *ardhje* të "një tjetër profeti" siç *ishin Musai* (Mojseu) dhe *Isai* (Jezusi) – Paqa qoftë mbi ta. Koncepti i të përmendurit të "Shpirtit të Shenjtë" në vend të "një tjetër profet" ëshët krejtësisht I mohuar në *Ungjillin e Gjonit*.

Për të kupuar mesazhin e Jezusit a.s. në këtë temë, duhet sëpari të fillohet me Letrën e Parë të Gjonit (1 Gjoni 2:1) në Bibël. Këtu, ju do të kuptoni se Jezusi a.s. ishte "Protektori/mbrojtësi origjinal": "Djema të mi, ju shkruaj këto gjëra që të mos mëkatoni; dhe në qoftë se ndokush mëkatoi, kemi një avokat te Ati, Jezu Krishtin të drejtin."

Jezusi a.s. i cili ishte "protektori/avokati origjinal" dhe ka parashikuar ardhjen e "një tjetër protektori/mbrojtësi". Megjithatë, redaktorët e Biblës e kanë përkthyer këtë "Protektor/mbrojtës" me shumë fjalë të ndryshme të cilat i hasin lexuesit e që mvaret nga ai i cili e shkroi Biblën, (p.sh., Protektor / Avokat / Ngushëllues / Ndihmues / Këshilltar / Fryma e Shenjtë / Shpirti i Shenjtë / Fryma e së vërtetës).

Termi i njëjtë "Protektor-*ngushëllues*" është përdorur në *Ungjillin e Gjonit* ku flitet në lidhje me profecinë e bërë nga Jezusi a.s. për ardhjen e "një tjetër protektori-*ngushëlluesi*". Ai thotë: "Dhe unë do t'i lutem Atit dhe ai do t'ju japë një *Ngushëllues* tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju." (Gjoni 14:16, Bibla) Ai gjithashtu u tha dishepujve të tij se ky "Protektor-*Ngushëllues*" do t'ua mësojë të gjitha gjërat dhe do t'i sjellë të gjitha gjërat për ta që t'i kujtojë. Ai ka thënë në (Gjoni 14:26, Bibla): "Por Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë,

që *Ati do ta dërgojë në emrin tim, do t`ju mësojë çdo gjë dhe do t`ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.*" Dhe në (Gjoni 15:26, Bibla): "*Por kur të vijë Ngushëlluesi, që do t`ju dërgoj prej Atit, Fryma e së vërtetës, që del nga Ati im, ai do të dëshmojë për mua.*"

Do të vëreni vetë në versetet e mësipërme se botimi (RSV) i Biblës e ka përdorur fjalën "*Këshilltar*" po ashtu siç është përmendur më lart (14:26) si "*Fryma e Shenjtë*". Por e njëjtë është ndryshuar në (Gjoni 15:26) siç shihet më sipër, në fjalën si "*Fryma e së vërtetës*" (15:26). Përsëri, në versetin vijues më poshtë, është rikthyer në "*Këshilltar*", por më vonë do të zbuloni se e njëjtë është kthyer sërisht në "*Fryma e së vërtetës*" në (Gjoni 16:13, Bibla).

(Gjoni 16:7-8, Bibla): "*Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë te ju Ngushëlluesi; por, po shkova, unë do t`jua dërgoj. Dhe kur të ketë ardhur, ai do ta bindë botën për mëkat, për drejtësi dhe për gjykim.*" Kjo është konfirmuar në Kur'an ku tregohet se Zoti e ngriti Jezusin a.s. dhe nuk u kryqëzua siç pretdohet.

Në versetin e mësipërm, (Gjoni 16:7-8, Bibla) ardhja e një "*Këshilltari*" ose "*Protektori/Ngushëlluesi*" varet nga largimi i Jezusit a.s. Përveç kësaj, Jezusi a.s. nuk ka treguar se ky "*Protektor/Ngushëllues*" do të vijë gjatë kohës së tij.

Në (Gjoni 16:12-15, Bibla), Jezusi a.s. vazhdoi profecinë e tij për ardhjen e këtij "*Protektori/Ngushëllesi tjetër*", të cilin e quajti si "*Fryma e së vërtetës*". Ai thotë: "*Kam edhe shumë gjëra të tjera për t`ju thënë, por ato ende ju nuk mund t`i mbani. Por, kur të vijë ai, *Fryma e së vërtetës*, ai do t`ju prijë në çdo të vërtetë, sepse ai nuk do të flasë nga vetja, por do të thotë gjitha ato gjëra që ka dëgjuar dhe do t`ju kumtojë gjërat që do vijnë. Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t`jua kumtojë. Të gjitha gjërat që ka *Ati* janë të miat; për këtë ju thashë se ai do të marrë prej*

simes dhe do t`jua kumtojë."

Verseti më lart ka demoluar konfuzionin e krijuar nga fjala 'Fryma e Shenjtë' ose 'Shpirti i Shenjtë' që u pretendohej nga të krishterët, sepse sipas Biblës në (Zanafilla 1:2, Bibla), kjo Fryma e Shenjtë kanë qenë në tokë që nga koha e Krijimit. Siç ishte gjithashtu i pranishëm në lumin Jordan, kur Gjoni pagëzoi Jezusin a.s. Pra, si mund që Jezusi të thotë: "*por, po shkova, unë do t`jua dërgoj [Frymën e Shenjtë/Ngushëlluesin]?*", në (Gjoni 16:7, Bibla) me çka deshi Jezusi të thoshte se "një tjetër Protektor/Ngushëllues" ose "tjetër profet" sikur ai do të vijë për shkak se dërgimi i Frymës së Shenjtë është plotësisht jashtë temës, sepse ai ka qenë tashmë këtu në tokë që nga dita e Krijimit të Universit.

Më tej, Fryma e Shenjtë dhe Fryma e së vërtetës janë dy terma të veçanta dhe dy entitete të pavarura. Më vonë merr përemrin "(he)-ai" duke qenë një figurë mashkullore, ndërsa i mëparëshmi e merr përemrin e gjinisë asnjëjse "(it)-ai/ajo". Jezusi a.s. ishte duke na thënë me fjalë të hapura se Këshilltari apo Fryma e së vërtetës (Ngushëlluesi) të cilin ai e profetizoi është një njeri, një profet sikur ai (Jezusi a.s.) dhe një birë i njerëzimit i cili do të na mësojë të gjitha gjërat.

Të gjitha përemrat "ai" të cilët ia referoi emrit "Fryma e së vërtetës" që shënohet në gjininë mashkullore për tu përputhur me fjalën "Këshilltar", në (Gjoni 16:7, Bibla). Fjala "Këshilltar" është fjalë përshkruese e cila përdoret në vend të fjalës "Fryma e së vërtetës" dhe gramatikisht, përemrat duhet që të përputhen në gjini me emrin me të cilin ata janë të lidhur. Pra, versetet 13 dhe 15 të Kapitullit 16 të Gjonit vërtetojnë se Fryma e së vërtetës nuk është një pjesë e Trinitetit. (47)

Përveç kësaj, në (Gjoni 16:13, Bibla) Jezusi a.s. e theksoi çështjen në lidhje me Frymën e së vërtetës, do të jetë

vetëm një profet i cili do të marrë urdhëresat dhe mësimet për atë çfarë duhet vepruar nga Zoti i Lartmadhërishëm: "ai nuk do të flasë nga vetja, por do të flaës çdo gjë që ai dëgjon." Të qenët vetëm një profet (jo një qenie hyjnore apo Shpirti i Shenjtë), ai nuk posedon autoritetin dhe pushtetin e vet, por i është dhënë fryshtësim (inspirim) nga Perëndia në qiej.

Për më tepër, ju do të vëreni se në (Gjoni 16:14, Bibla), Jezusi a.s. thotë për Frymën e së vërtetës: "*Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej meje dhe do t'jua kumtojë.*" Kur'ani i cili është mesazhi i Muhamedit a.s. i ka përlëvdruar të dy, Jezusin (Isain) a.s. dhe nënën e tij Marinë (Merjemin). Emri i Isait a.s. është përmendur në Kur'anin e Shenjtë pesë herë më shumë se sa emir i Muhamedit a.s. Dhe fakti që e tërë kaptina (sureja) 19-të e Kur'anit të Shenjtë ishte e specifikuar në emër të Merjemit (d.m.th. Kaptina Merjem), vërtetoi me elokuencë argumentet tona se në të vërtetë Isai a.s. ishte i përlëvdruar në mënyrë të jashtëzakonshme.

Për më tepër, në (Gjoni 14:26, Bibla) Jezusi a.s. thotë: "*Do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë.*" Kjo është arsyaja se përse mesazhi i Muhamedit a.s., e që është Kur'ani i Shenjtë, është një mesazh i përbushur që përfshin mesazhin e Jezusit a.s. dhe të gjitha mesazhet e mëparshme. Në fakt, Kur'ani është konfirmim i mesazhit të Jezusit a.s. dhe atyre mesazhe që erdhën para tij. Ai është një mesazh gjithëpërfshirës që i mbulon të gjitha aspektet e përpjekjes njerëzore qofshin ato që lidhen me raportet personale, sociale, politike, ekonomike apo ndërkombëtare. Ai quhet **ISLAM** (fe e nënshtimit ndaj vullnetit të Zotit Një të Vërtetë – Allahu). Ky është një Kod tërësor i Jetës si dhe një mesazh universal i cili i drejtohet të gjithë njerëzimit që të shpie njeriun në pajtim me veten dhe me Zotin që të arrihet vullneti i Zotit, me të cilën fitohen fryshtet e Shpëtimit.

Gjithashtu, në (1 Gjoni 4:6, Bibla) që të dy termat "*Fryma e së vërtetës*" dhe "*fryma e së gabuarës*" janë përdorur për qenie njerëzore. Dhe, në botimin e vjetër të Biblës `MSS`, në Dorëshkrimin `Codex Syriacus` e cila u zbulua në vitin 1812 në Malin e Sinait nga znj. Anges S. Leëis dhe znj. Bensley, në tekstin e (Gjoni 14:26, Bibla), thuhet: "Protektori/Ngushëlluesi, Fryma" dhe jo "Protektori/Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë". Termi "Fryma" që është referuar nga ana e botimit të vjetër të Biblës `MSS` është referencë ndaj termit "Fryma e së vërtetës", e cila është sjellur në (Gjoni 15:26, Bibla) në Biblën e sotme.

Së fundi, të reflektojmë dritë mbi çështjen që tka thënë profeti Jezusi a.s. në (Mateu 21:42-43, Bibla): "*Prandaj unë po ju them se juve do t'ju hiqet mbretëria e Perëndisë dhe do t'i jepet një kombi që do ta bëjë të japë fryt.*"

Duhet patur parasysh, se paralajmërimi i Jezusit a.s. për çifutët, në lidhje me ndodhinë kur ata braktisën fenë e tyre duke besuar dhe adhuruar hyjni tjera përveç Zotit të Plotfuqishëm, baza e të cilit gjendet në (Zanafilla 49:10, Bibla) ku profeti Jakob a.s. paralajmëron për Judën. Ai ishte në fakt përbushja e profecisë së mëhershëmë në (Ligji i Përtërirë 32:21, Bibla) Zoti thotë: "*Ata më kanë bërë ziliqar me atë që nuk është Perëndi, kanë provokuar zemërimin tim me idhujt e tyre të kotë; dhe unë do t'i bëj ziliqarë me njerëz që nuk janë një popull, do të ngacmoj smirën e tyre me një komb që s'është në vete.*"

Arabët para Islamit ishin të cilësuar nga Perëndimi si komb që s'është në vete (të pamend). Një shkrimtar i portretizoi ata si "kafshë me lëkurë të njeriut", e pasi që erdhi Islami tek ata, u bënë model i njerëzimit. *Profeti Muhamed a.s. i largoi të gjitha gjurmët e idhujtarisë dhe predikoi Njëshmërinë e Zotit – Krijuesit. Ai i vetmi është Zot (Perëndi), Furnizuesi dhe Mbajtësi i të gjitha botëve, Ai i Cili nuk ka shok, ortak, bashkëpunëtor, familje, pasardhës apo ndihmëtar. Populli arab në përgjithësi dhe Muhamed i a.s.*

në veçanti paraqesin përbushjen e të gjitha profecive të mëhershme.

Çka është Kur'ani dhe çka thotë për Jezusin a.s. dhe nënën e tij

Kur'ani i Shenjtë është një mesazh gjithëpërfshirës dhe universal i cili i është shpallur profetit Muhamed a.s. nëpërmjet të ndërmjetësisë së engjëllit Xhibril si amaneti i fundit dhe përbyllës i Zotit për njerëzimin. Ai është mëshirë dhe udhëzim nga ana e Zotit për qeniet njerëzore i cili është një Kod tërësor i Jetës, që i përfshin të gjitha aspektet e përpjekjes njerëzore (p.sh., kodi i sjelljes personale, marrëdhëniet shoqërore, politike, ekonomike dhe kodi i marrëdhënieve ndërkombëtare). Ky sistem u rezistoi sfidave të kohës sepse Vetë Zoti e ka atë nën mbrojtjes e Tij. Për këtë arsy, ai është Libri i vetëm i Zotit i përhapur sot, i cili mbetet i pastër pas më shumë se 1400 vjet. Ai konfirmon të gjitha shpalljet e mëparshme të profetëve të mëhershëm dhe i korrigon gabimet që depërtuan në shpalljet e mëparshme duke anuluar gjithçka që ndodhej në to. Allahu xh.sh. thotë:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).

Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës).

Lexo! Se Zoti yt është më bujari!

Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë.

Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.

Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë,

Për shkak se e ndien veten të pavarur.

Po kthimi është vetëm te Zoti yt." (El-Alek 96:1-8, Kur'ani)

"Shpallja e librit (e Kur'anit), nuk ka dyshim se është (shpallje) nga Zoti i gjithësisë." (Es-Sexhde 32:2, Kur'ani)

"Edhe ky (Kur'an) është libër që e zbritëm; është i bekuar, vërtetues i të mëparshmes..." (El-En'am 6:92, Kur'ani)

"Ne nuk ta shpallëm ty për tjetër Kur'anin, vetëm që t'u sqarosh atyre atë për çka u përçanë, e (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë." (En-Nahl 16:64, Kur'ani)

"Ne ta shpallëm ty librin me argumete për njerëz, e kush orientohet në rrugën e vërtetë, ai e ka për vete, e kush e humbë, ai i bën dëm vetëm vetes, e ti nuk je garantues i tyre." (Ez-Zumer 39:41, Kur'ani)

Në fakt, sipas komentatorëve të Kur'anit, ekzistojnë tre qëllime që shprehin qartë për zbritjen e tij profetit Muhamed a.s.:

- (1) ngase ajo do të sjellë unitetin nëmes sekteve të ndeshura, për Ungjillin e Unitetit dhe do të predikojë Njëshmërinë e Zotit të Vërtetë;
- (2) se shpallja do të jetë një udhërrëfyes për arrijen e sjelljes shembullore; dhe
- (3) se ajo do të hapë rrugën e pendimit dhe shpëtimit, kështu që të arrihet mëshira e madhe për të humburit mëkatarë. Me të vjen urdhëri për burrat dhe gratë që të jenë të drejtë dhe të ndershëm. Nëse ata refuzojnë atëherë humbja u takon vetëm atyre. (48)

Roli i Jezusit a.s.

"Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: "Bëhu"! ai u bë." (Ali Imran 3:59, Kur'ani)

"Madje për shkak të thënies së tyre: "Ne e kemi

mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, tē dërguarin e All-llahut". Po ata as nuk e mbytēn as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan nē gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë nē dilemë pér tē (pér mbytje) e nuk kanë pér tē kurrfarë dije tē saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytēn atë.

Përkundrazi, All-llahu e ngriti atë pranë Vetes. All-llahu éshtë i poltfuqishëm, i dijshëm.

Nuk ka asnë nga ihtarët e librit vetëm se ka pér t'i besuar atij (Isait) para vdekjes së vet, e nē ditën e gjykimit ai dëshmon kundër tyre." (En-Nisa 4:157-159, Kur`ani)

"O ihtarët e librit, mos teproni nē fenë tuaj dhe mos thuani tjetër gjë pér All-llahun, përveç asaj që éshtë e vërtetë. Mesihu, Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i All-llahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni pra All-llahun dhe tē dërguarin e Tij e mos thoni: "Tre" (trini). Pushoni (së thëni), se éshtë më mirë pér ju. All-llahu éshtë vetëm një All-llah; larg qoftë asaj që Ai tē ketë fëmijë. C'ka nē qiej dhe ç'ka nē tokë éshtë vetëm e Tij. Mjafton që All-llahu éshtë planifikues i pavarur." (En-Nisa 4:171, Kur`ani)

"Bënë kufër (mohuan tē vërtetën) ata që thanë: "All-llah éshtë ai, Mesihu, biri i Merjemes". E vetë Mesihu, (Isai), tha: "O beni israilë, adhurojeni All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhennetin dhe vendi i tij éshtë zjarri. Pér mizorët nuk ka ndihmës.

Gjithashtu bënë kufër (mosbesim) ata që thanë: "All-llahu éshtë i treti i treve". S'ka nē gjithësi tjetër pos një All-llahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zotëra), do t'i kapë dënim i dhembshëm ata që nuk besuan prej tyre.

E pse tē mos pendohen dhe tē kërkojnë te All-llahu falje, kur All-llahu dihet se falë shumë, éshtë mëshirues?

Mesihu, biri i Merjemes, nuk është tjetër vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si ia kthejnë shpinën të vërtetës!

Thuaju: A adhuroni pos All-llahut atë që nuk mund t'ju sjellë as dëm e as dobi? All-llahu është që dëgjon (ç'thoni) që di (ç'veproni)." (El-Maide 5:72-76, Kur'ani)

"Dhe kur All-llahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos All-llahut!?" (Isai) Tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, ti do ta dije. Ti e di ç'ka ka në mua, e unë nuk di çka ka në Ty. Ti je më i dijshmi i të fshehtave!"

Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni All-llahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send!"" (El-Maide 5:116-117, Kur'ani)

"Kjo është (fjalë) e vërtetë, rrëth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata shkaktojnë dyshime.

Nuk i takoi (nuk ka nevojë) All-llahu të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: Bëhu!". Ai menjëherë bëhet.

(Isai i tha popullit të vet) Dhe se All-llahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhurojeni Atë, kjo është rrugë (fë) e drejtë." (Merjem 19:34-36, Kur'ani)

"Ata thanë: "I Gjithëfuqishmi ka fëmijë".

Ju (jobesimtarë) vërtet sollët një fjalë shumë të shëmtuar.

Aq të shëmtuar sa gati u copëtuan qiejt, gati pëlciti toka dhe gati u shembën kodrat nga ajo (fjalë).

Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë.

E të Gjithëmëshirshmit nuk i takon të ketë fëmijë.

Nuk ka tjetër, vetëm se gjithë çka është në qiej e në tokë ka për t'iu paraqitur Zotit si rob." (Merjem 19:88-93, Kur'ani)

"Maria (Merjemi) kurrë nuk pretendoi të ishte nënë e Perëndisë, apo djali i saj të ishte Perëndi. Ajo ishte një grua e devotshme dhe me virtute të larta, ndërsa Jezusi mohon në këtë rast të ketë dijeni në lidhje me çfarëdo gjërash që i atribuohen atij duke përdorur emrin e tij. Adhurimi i Marisë, edhepse është i hedhur poshtë nga Protestantët, u përhap gjithandej nëpër kishat e mëhershme, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim." (49)

Përveç kësaj, referencat e mëposhtme në Bibël gjithashtu do t'ju japid të kuptoni mësimet e Jezusit a.s. Në Ungjillin e (Mateu 4:10): "Atëherë Jezusi i tha: ``Shporru, Satan, sepse është shkruar: "Adhuro Zotin, Perëndinë tënde, dhe shërbeji vetëm atij``." Në (Gjoni 20:17), ku ai i drejtohet Maria Madgalenës me fjalët: "Shko të vëllezërit e mi dhe u thuaj atyre se unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj``." Në (Luka 18:19), ku ai e qorton njëfarë sundimtari për shkak se e ka thirrur atë Mësues i mirë, "Përse më quan të mirë? Askush nuk është i mirë, përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë." Dhe në (Marku 12:29) ku ai thotë: "Urdhërimi i parë i të gjithëve është: "Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zoti."

Tregim i çuditshëm

Ky është një tregim për tre adhurues të zjarrit (zjarrëputistë) të cilët u bënë të krishterë dhe ishin dishepuj të devotshëm të priftit. Ai u mësoi atyre fenë krishtere, veçanërisht Trinitetin. Për të studijuar doktrinën më tepër, ata qëndruan me priftin. Pas një kohe, një mik i

priftit erdhi për ta vizituar atë dhe e pyeti në lidhje me konvertimin e tre zjarrëputistëve. Prifti ishte mjaft krenar që ishte duke përmendur tre të konvertuarët dhe studimet e tyre për dogmën krishtere. Prifti e thirri njërin nga ata tre për të treguar shkathtësinë e tij pëpara vizitorit në lidhje me mësimet e Trinitetit.

Njeriu me plot gazë ia filloi: "*Ti më mësove se ekzistojnë tre perëndi në një Zot. Një në qiell, i dyti i lindur nga virgjëresha Mari dhe i treti, Fryma e Shenjtë, i cili i zbriti Mesias në formë të një pëllumbi, në kohën kur perëndia i dytë ishte tridhjetë vjeç.*" Me të dëgjuar këtë, prifti u zemërua dhe e nxorri jashtë duke i thënë se ky njeri është i marrë. Pas këtij, ai e thirri njeriun e dytë dhe ia parashtroi të njëjtën pyetje. Njeriu i dytë u përgjigj: "*Ti më mësove se fillimisht ishin tre perëndi, prej të cilëve njëri u kryqëzua dhe vdiq, dy mbetën prapa.*" Prifti u zemërua përsëri dhe e nxorri atë jashtë. Pastaj e thirri të tretin i cili ishte krahasimisht më inteligjent se të mëparëshmit dhe e pat mësuar fenë me zell. Prifti i kërkoi atij që ta paraqesë dogmën e Trinitetit. Njeriu u përgjigj: "*Atë çfarë më ke mësuar mua, përmes bekimeve të Mesias, unë i kam mësuar me zell, e që është – një është tre dhe tre është një. Njëri prej të cilëve u kryqëzua dhe vdiq. Kështu që me vdekjen e njërit, vdiqën të tre perënditë, sepse të tre janë një dhe të bashkuar, andaj vdekja e njërit është vdekje e të treve, përndryshe nuk do të kishte bashkim të tyrë.*" (50)

Kjo do të thotë se për shkak të kryqëzimit siç pretendohet nga të krishterët, të dy Zoti dhe Jezu Krishti a.s. u prishën dhe u zhdukën, sepse sipas besimit të tyre, Jezusi është Perëndi dhe profet, pas vdekjes e të cilit të krishterët nuk kanë as Zot, as Profet dhe as Frymë të Shenjtë. Kështu që, me anë të bashkimit, të tre perënditë vdiqën me vdekjen e Krishtit. Shkurt thënë, të dyja uniteti (bashkimi) dhe triniteti gjithashtu u prishën pas zhdukjes së Zotit (Perëndisë), sepse uniteti dhe triniteti mbeten me

ekzistencën e Zotit. Me zhdukjen e Zotit nga skena, atëherë natyrisht që duhet të zhduken edhe atributet e tij.

Paralajmërim për ata të cilët e parandalojnë Mesazhin e Zotit

Libri më i mirë është Libri i Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit s.a.v.s.

Allahu u drejtohet me një paralajmërim të vrazhdë atyreve të cilët e parandalojnë dhe e pengojnë mesazhin e Tij origjinal t'i arrijë njerëzimit.

"Eshtë shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është prej All-llahut"! E për të arritur me të një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë." (El-Bekare 2:79, Kur'ani)

"Eshtë e vërtetë se atyre që nuk besuan nuk do t'u vlejë asgjë para All-llahut, as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata vetë janë lëndë e zjarrit." (Ali Imran 3:10, Kur'ani)

"Feja e pranueshme tek All-llahu është Islami." (Ali Imran 3:19, Kur'ani)

"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshëpruarit." (Ali Imran 3:85, Kur'ani)

"O ju që besuat, kini frikë All-llahun me singjeritet të vërtetë dhe mos vdisni, pos vetëm duke qenë muslimanë (besimtarë)!" (Ali Imran 3:102, Kur'ani)

"Ne do to mbjellim frikën në zemrat e atyre që nuk

besuan sepse ata All-llahut i trillojnë e i mveshin zota të tjerë, duke mos pasur për këtë kurrfar fakti, ndaj vendbanimi i tyre do të jetë xhehennemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve." (Ali Imran 3:151, Kur'ani)

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra." (En-Nisa 4:1, Kur'ani)

"Eshtë e vërtetë se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i bëhet Atij shok, e pos këtij (mëkati), të tjerat i falë atij që dëshiron. Ai që i përshkruan shok All-llahut, ai ka humbur dhe bërë një largim të madh (prej të vërtetës)." (En-Nisa 4:116, Kur'ani)

"Thuaj: "A pos All-llahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa vetë nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër?"" (El-En'am 6:14, Kur'ani)

"Kush është më mizor se ai që trillon shpifje ndaj All-llahut, apo i përgënjeshtron argumentet e Tij?" (El-A'raf 7:37, Kur'ani)

"A i përshkruajnë shok atë çka nuk mund të krijojë asnjë send, e ata (idhujt) vetë janë të krijuar.

Ata (idhujt) nuk mund t'u sjellin atyre ndonjë ndihmë e as veten e tyre ta ndihmojnë." (El-A'raf 7:191-192, Kur'ani)

"Nuk ka tjetër, vetëm se gjithë çka është në qiej e në tokë ka për t'iu paraqitur Zotit si rob." (Merjem 19:93, Kur'ani)

"Mirëpo, ata (idhujtarët) në vend të Tij adhuruan zota të tjerë, të cilët nuk krijuan asgjë, sepse ata edhe vetë janë të krijuar. Ata nuk posedojnë për vetvete as dëm as dobi, ata nuk kanë në dorë as vdekje as jetë, e

as *ringjallje*." (El-Furkan 25:3, Kur'ani)

"*E kush është më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut, ose përgënjeshtron të vërtetën pasi t'i ketë ardhur ajo? Po, a nuk është xhehennemi vend për jobesimtarët?*" (El-Ankebut 29:68, Kur'ani)

"*Nëse ju nuk besoni, All-llahu nuk është nevojtar për ju; megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet, e nëse jeni mirënjoës ndaj Tij, Ai e pëlqen atë për ju. Ndërkaq, nuk do ta bartë asnje mëkatar barrën e tjetrit...*" (Ez-Zumer 39:7, Kur'ani)

"*Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët.*" (El-A'raf 7:179, Kur'ani)

Shënime dhe bibliografia

- (1) Victor Paul Wirewille** në "*Jesus Christ Is Not God*", botuar në American Christian Press, The Way International, New Knoxville 45871 (1975 and 1981), fq. 4.
- (2) Shock Survey of Anglican Bishops:** *Daily News*, U.K., 25 / 6 / 84, (burimi për informim: Islamic Propagation Centre International, 20 Green Lane,

Small Heath, Birmingham B9 5DB, Tel. 021-773 0137).

- (3) Bishop Jenkins Slams Fundamental Christian Doctrine: London Daily Mail, nga faqja 12, 15 / 7 / 84(burimi: Ibid)
- (4) London Daily Mail, U.K., fq. 12, 15 / 7 / 84, (burimi: Ibid)
- (5) Bamber Gascoigne në "The Christians", botuar në Granada Publishing Limited, 1976, Frogmore, St Albans, Herts Al2 2NF and 3 Upper James Street, London Wir 4BP, fq.9.
- (6) J. R., dummelow: *Commentary on the Holy Bible*, fq. 16. – (shih – znj. Ulfat Aziz-Us-Samad në "Islam and Christianity", 1984, botuar në Presidency of Islamic Research IFTA and Propagation, Riyadh, Kingdom of Saudi Arabia fq. 7)
- (7) T.G. Tucker nw "The History of the Christian in the Light of Modern Knowledge", fq. 320. (burimi: Ibid, fq. 6)
- (8) Encyclopaedia Britannica, Macropaedia, Vëllimi. 4, *Christianity*, fq. 481)
- (9) Znj. Ulfat Aziz-Us-Samad në "Islam and Christianity", botuar më vitin 1984, në Presidency of Islamic Research, IFTA and Propagation, Riyadh, Kingdom of Saudi Arabia fq. 29.
- (10) I. William Wilson Stevens në "Doctrine of the Christian Religion" (Botuar në Grand Rapids: Wm. B. Eerdmans Publishing Co., 1967, fq. 113-122. (Shih – Victor Paul Wierwille në "Jesus Christ is not God", botuar në American Christian Press. The Way International 1975-1981, New Knoxville, Ohio 45871, fq. 5).
- (11) Bible and Tract Society of Pennsylvania në "Should You Believe in Trinity?" botuar më vitin 1989, në Int'l. Bible Students Association Brooklyn, New York, U.S.A. fq. 3.
- (12) Victor Paul Wierwille në "Jesus Christ is not God", botuar në American Christian Press. The Way

International, New Knoxville, Ohio 45871, (1975-1981), fq. 22-23.

(13) Hase në "A History of the Christian Church", fq. 111. (Shih – Ibid, fq. 23).

(14) Henry Chadwick në "The Early Church", botuar në Grand Rapids: Wm. B. Eerdmans Publishing Co., 1968), fq. 129. (Shih – Ibid, fq.23).

(15) Henry Bettenson nw "Documents of the Christian Church", bot. 2-të (botuar në London: Oxford University Press, 1963), fq. 58. "Ariusi dhe ndjekësit e tij ishin menjëherë të dëbuar për në Iliri dhe veprat e tij i kishin djegur. Ushtimat që u ndien pwr trajtimin e tillë ndaj Ariusit patën efekt të thellë në Kishën, si edhe nw mbretin Konstantin, pwr disa dekada. Sapo ishte për t'iu falur Ariusit nga ana e mbretit Konstantin dhe të kthehej në pozitën e mëparshme në Kishë, ai vdiq." (Shih – Ibid, fq. 24).

(16) Encyclopaedia Britannica, 1968, s.v. "Council of Nicaea." (Shih – Ibid, fq. 24-25).

(17) Victor Paul Wierwille në "Jesus Christ is Not God", botuar në American Christian Press, New Knoxville, Ohio, fq. 26-27.

(18) B.K. Kuiper në "The Church in History", botuar në Grand Rapids: Wm. B. Eerdmans Publishing Co., fq. 128 (Shih – Ibid, fq.25).

(19) Bamber Gascoigne në "The Christians", botuar në Granda Publishing Limited, 1976, Frogmore, St Albans, Herts AL2 2NF dhe 3 Upper Jemes Street, London Wir 4BP, fq. 9).

(20) Encyclopaedia Britannica, Macropaedia, Vëllimi 4, Christianity, fq. 483.

(21) Bible and Tract Society of Pennsylvania në "Should You Believe in Trinity?", botuar më vitin 1989, në Int'l. Bible Students Association Brooklyn, New York, U.S.A. fq. 11.

(22) Ibid, fq. 1.

(23) Rev. J.F. De Groot në "Catholic Teaching", fq, 101.

(Shih – Znj. Ulfat Aziz-Us-Samad në "Islam and Christianity", botuar më vitin 1984, në Presidency of Islamic Research IFTA and Propagation, Riyadh, Kingdom of Saudi Arabia fq. 30)

(24) Bible and Tract Society of Pennsylvania në "Should You Believe in Trinity?", botuar më vitin 1989, në Int'l. Bible Students Association Brooklyn, New York, U.S.A. fq. 4.

(25) The New Catholic Encyclopaedia, botuar më vitin 1967, në "The Holy Trinity", Vëllimi 14, fq. 299. (Shih – Znj. Ulfat Aziz-Us-Samad në "Islam and Christianity", botuar më vitin 1984, në Presidency of Islamic Research IFTA and Propagation, Riyadh, Kingdom of Saudi Arabia, fq. 32).

(26) The New Catholic Encyclopaedia, botuar më vitin 1967, në "The Holy Trinity", Vëllimi 14, fq. 295. (Shih Ibid, fq. 31).

(27) Bible and Tract Society of Pennsylvania në "Should You Believe in Trinity?", botuar më vitin 1989, në Int'l. Bible Students Association Brooklyn, New York, U.S.A. fq. 6.

(28) Ibid, fq. 6.

(29) Ibid, fq. 6.

(30) London Daily Mail, nga faqja 12, 15 / 7 /84, (Shih- Islamic Propagation Centre International, 20 Green Lane, Small Heath, Birmingham B9 5DB, Tel. 021- 773 0137).

(31) John Hick në "The Myth of God Incarnate", botuar më vitin 1977, në SCM Press Ltd, 58 Bloomsbury Street, London WC1, nën artikullin "Jesus and the World religion", fq. 178).

(32) Victor Paul Wierwille në "Jesus Christ is not God", botuar në American Christian Press. The Way International, New Knoxville, Ohio 45871, fq. 12.

(33) Ibid, fq. 9.

(34) Thëni, veprimet apo Sunneti dhe traditat e profetit Muhamed a.s. Ato konsiderohen si komentim (shpjegim) i Kur'anit Famëlartë. Prandaj, ai

(sunneti) është i dyti në rradhë pas Kur'anit, e të dy sëbashku paraqesin burimet e padyshimta të Sheri'atit, gjegjësisht Jurisprudencës Islame.

- (35) Wellhausen në "*Einleitung in die Drei Evangelien*", botuar në Reimer, më vitin 1905, fq. 113, i referuar nga Dennis Nineham në artikullin e tij "*Epilogue*" të "*The Myth of God Incarnate*", botuar në SCM Press Ltd. 58 Broomsbury Street, London, më vitin 1977, fq. 192).
- (36) Revised Standard Version (RSV), e përkthyer nga gjuhët origjinale i cili version ishte i dërguar A.D. 1611. Revised A.D. 1881-1885 dhe A.D. 1901 e kahasuar me autoritetet më të vjetra dhe e korrigjuar A.D. 1946-1952. Botimi i dytë i "The New Testament A.D." më vitin 1971; the New International Version (NIV), copyright 1973, 1978, 1984 by International Bible Society, 144 Tices Lane, East Brunswick. NJ 08816); New World Translation of the Holy Scripture 1984, Watchtower Bible and Tract Society of New York, Inc., International Students Association, Brooklyn, New York, U.S.A.
- (37) The New Testament – Një përkthim dhe shpjegim i bazuar nw dorëshkrimet më të vjetra (përkthim nga Gjermanishtja në Anglisht; më vitin 1937), nga Johannes Greber.
- (38) New World Translation (New York; 1961).
- (39) A.M. TRUST, POST BOX 81075, BURNABY, B.C. V5H 4K2 Ph. 298-8803
- (40) Suretu El-Bekare, 2:117, Kur'ani.
- (41) Victor Paul Wierwille në "*Jesus Christ is not God*", botuar në American Christian Press, The Way International, më vitin 1975, në New Knoxville, Ohio, fq. 5.
- (42) John Hick në "*The Myth of God Incarnate*", botuar në SCM PRESS LTD., 58 Bloomsbury Street, London WC1, Botimi i gjashtë më vitin 1981, nën titullin "*A Cloud of Witnesses*", nga Francis

Young, fq. 26.

(43) John Hick në "The Myth of God Incarnate", botuar në SCM PRESS LTD., 58 Bloomsbury Street, London WC1, Botimi i gjashtë më vitin 1981, fq. 6, nën titullin: "Christianity Without Incarnation", nga Maurice Wiles.

(44) Ibid, pjesa e 3-të, fq. 1.

(45) Cf. Berson në "The Creative Evolution", Modern Library.

(46) Suretu Et-Tegabun, 64:2, Kur'ani Famëlartë, Përkthim me komentim në gjuhën shqipe, H. Sherif Ahmeti, fq. 650.

(47) Victor Paul Wierwille në "Jesus Christ is not God", botuar në American Christian Press, The Way International, New Knoxville, Ohio 45871, fq. 143.

(48) Abdullah Yusuf Ali: *The Holy Qur'an*, English Translation of the meanings and commentary, n. 2091, fq. 750.

(49) Ibid, n.783, fq. 311; n. 829 dhe n. 830, fq. 327 me referencë në (Cf. v. 72, and n. 782), fq. 310.

(50) Al-Jawab-ul-Fasih. fq. 369.

www.islamic-invitation.com

